



Fermerët kërkojnë të kalojnë në subvencione direkte për prodhimin

Faqe 4



Rama me fermerët: Ramë dakord që ndryshimi i qasjes së financimit nga qeveria është i duhuri

Faqe 5



FED invest - Më shumë shërbime për fermerët, risitë teknologjike në sektorin e Mikrofinancës

Faqe 3



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15 ditëshi i parë i muajit dhjetor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 427
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

AKADEMIA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS, SFIDAT E VRESHTARISË KASH PJESË E SIMPOZIUMIT SHKENCOR "VRESHTARIA DHE VERËTARIA NË HAPËSIRËN MBARËSHQIPTARE."

Fokus i Simpoziumit është pikërisht konsolidimi i prodhimit cilësor dhe standardizimi i mirëfilltë, marketingu dhe evidentimi më i plotë i verërave shqiptare, për të zënë vendin që u takon në tregun vendas, përtëritja e strategjisë dhe e politikës verëtare në mënyrë që të vihet në kushte të barabarta e madje të privileguara ndaj verërave të huaja

RISI ALBANIA

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Armela, studentja e UBT-së, që me mbështetjen e programit ExportStars, u punësua si konsulente për eksportet, në kompaninë Amarilto SHPK në Lezhë



Faqe 2



UBT



Universiteti Bujqësor i Tiranës, njehsim i diplomës me atë të Vjenës

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Faqe 11, 12

Deputeti Braçe për ndryshime në Paketën fiskale 2022

Deputeti Erion Braçe, nga foltorja e Kuvendit tha se duhet të ketë disa përmirësime në buxhetin e vitit 2022. Braçe ka bërë të njëjtat propozime me ato të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në mbrojtje të interesave të fermerëve.



Faqe 2

BUXHETI PËR BUJQËSINË

Protesta të fermerëve, Krifca: Disa kërkesa të adresuara në buxhetin 2022



Faqe 5



RISI ALBANIA

Armela, studentja e UBT-së, që me mbështetjen e programit ExportStars, u punësua si konsulente për eksportet, në kompaninë Amarilto SHPK në Lezhë

Nuk është e lehtë sot të gjallërosh jetët e të rinjve në komunitetet rurale, në një kohë kur largimi tyre është kthyer

e dytë, master shkencor Ekonomi dhe Politika Agrare, pranë Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Falë punës së saj dhe ekipit

këpunon me kompaninë në rolin e konsulentës për eksportet.

Sot shumëkush mendon se pozicionet e punës në agrobiznes janë tradicionale dhe jo tërheqëse për të rinjtë & të rejtat?

Shembulli i Armelës, një menaxhere e re eksportesh dëshmon të kundërtën.

Madje është frymëzim edhe për shumë të rinj të tjerë, që të guxojnë dhe të integrohen në tregun e punës, në sektorin rural, si alternative e mirë për progresin profesional dhe ekonomik të tyre dhe më gjerë.

Projekti RisiAlbania beson fort në rolin e rëndësishëm të rinisë shqiptare në zhvillimin dhe progresin e vendit tonë.

Që prej disa vitesh, Risi Albania bën përpjekje për të konsoliduar programin e konsulentëve pranë kompanive të ndryshme agro, për të mundësuar të rinjtë, veçanërisht ata të zonave rurale, të ushtrojnë “zërin” e tyre për të ndikuar politikëbërjen bujqësore dhe rurale, për t’i bërë këto procese të orientuara dhe të lidhura ngushtë me shqetësimet, interesat dhe prioritetet e të rinjve.

Fokus i programit RisiAlbania është mbështetja e të rinjve, që ata të luajnë rolin e tyre të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, e në veçanti në transformimin e komuniteteve rurale.



në një fenomen me tendencë gjithmonë në rritje.

E megjithatë, përkundër këtij fakti, ende të rinjtë në komunitetet rurale frymëzojnë me modelin e reja që po krijojnë apo historitë e tyre të suksessit, falë kjo edhe mbështetjes apo orimitimit që po marrin nga projektet e ndryshme të donatorëve të huaj.

I tillë është shembulli i Armela Dukas, studentes në vitin

të studentëve si pjesë programit #ExportStars, nga Koestinger Consulting, kompania Amarilto SHPK në Lezhë rezultoi në një shembull real se si energjia dhe idetë e të rinjve, i vijnë në ndihmë zhvillimit të eksporteve në bujqësi.

Kompania nisi marrëdhënien tregtare duke eksportuar në një rrjet supermarketesh në Zvicër.

Armela tashmë bash-

Bimët Aromatike Mjekësore, së shpejti formalizimi i klasterit të Tepelenës

Kryetari i bashkisë Tepelenë Tërmet Peçi, priti në një takim pune Zv. Ambasadorin e Misionit të Ambasadës Zviceriane në Shqipëri, Patrik Meier. Gjatë këtij takimi kreu i bashkisë Peçi shprehu mirënjohje, për mbështetjen e vazhdueshme që shteti zvicerian ofron nëpërmjet programeve zhvillimore në Shqipëri.

Z. Meier, u njoh me nevojat dhe potencialin që Tepelena ka, sa i përket resurseve natyrore, kulturore historike e njerëzore, punën e zhvilluar deri më tani me “Klasterin e Bimëve Medicinale Natyrore” në Tepelenë, si dhe rrjetëzimin e operatorëve të turizmit në qark nëpërmjet organizatës “Visit Gjirokastra”. Projekte të cilat kanë një kohështrirje zhvillimi në tre vitet e fundit në Tepelenë, mbështetur nga programi zvicerian Risi Albania.

Kontribute tepër të çmuara këto, për të hedhur të sigurt hapat e para të bashkëpunimit dhe zhvillimit në tërësi të qarkut Gjirokastër. Me garancinë e vijimësisë së këtyre projekteve të nisura, nga të dy palët u shpreh vullneti i plotë, për të

vijuar me hapa të mëtejshëm, në zhvillimin e kapaciteteve, hartimin e strategjisë ekonomike, mbështetur mbi eksperiencat e suksesshme të shtetit zvicerian, kombinuar me burimet potenciale në zonë, të cilat mund të vihen në shërbim të ekonomisë dhe turizmit, si një sektor dinamik gjithëpërfshirës.



Në sektorin e Bimëve Aromatike Mjekësore, së shpejti pritet formalizimi i klasterit të Tepelenës, ku përfshin dhjetëra fermerë në zonë, të cilët duke qenë aktivë së bashku mund të krijojnë mundësimin për thithjen e granteve nga skemat e IPARD dhe financimin e kulturave në zonë. Gjithashtu jo pak i rëndës-

sishëm mbetet sektori i turizmit, ku me vazhdimësinë e programit për 4 vitet e ardhshme, do të mund të rritë cilësinë e informacionit, shërbimit dhe rrjetëzimin e operatorëve turistik për shkrimin e vizitorëve dhe rritjen e të ardhurave për familjet që ofrojnë produkte.

Në takim morën pjesë: Drej-

tori i Ekipit të Komponentit të Sektorit Privat pranë Risi Albania, z. Andi Stefanllari, Kryetari i Këshillit Bashkiak z. Elvis Shehu, Përgjegjës i Projekteve të Huaja dhe Turizmit z. Aleksandër Toti, Drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Gëzim Shehu, si dhe i ftuar nga fusha e biznesit për turizmin z. Neritan Lula.

TEMA TË DITËS

Grante për bizneset e vogla rurale

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca bëri të ditur se, sot qeveria ka miratuar një projektvendim për të nxitur përpara “Programin e Zhvillimit të Qëndrueshëm Rural”, që zbatohet në bashkëpunim me qeverinë e Republikës së Gjermanisë, që e financon me një fond prej 15 milionë euro.

“Sot kemi miratuar fondin prej 5.75 milionë euro, mbështetje e cila do të ofrohet për dy komponentë, – tha Krifca, teksa shpjegoi se, – 3 milionë euro do të adresohen për mbështetjen e incentivave që rrisin konkurrueshmërinë e fermerëve shqiptarë dhe pjesa tjetër për rritjen e aksesit në financim, përmes granteve për

bizneset e vogla rurale që e kanë të pamundur të marrin financim nga bankat”. “Përmes këtij financimi mbështesim fermerët të cilat

pandemia. Është një mbështetje e cila do të funksionojë prej fundit të këtij viti dhe do të vijojë gjatë 2022”, deklaroi Krifca



kanë pasur problematika dhe janë prekur nga situata e krijuar nga

në konferencën për mediat pas mbledhjes së qeverisë.

Deputeti Braçe për ndryshime në Paketën fiskale 2022

Deputeti Erion Braçe, nga foltorja e Kuvendit tha se duhet të ketë disa përmirësime në buxhetin e vitit 2022. Braçe ka bërë të njëjtat propozime me ato të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH) në mbrojtje të interesave të fermerëve.

Siç bëri në komisionin e Ekonomisë Braçe ka lexuar relacionin e projektligjit për TVSH në vitin 2014, kur qeveria propozoi barazimin e TVSH për fermerët në shitje dhe blerje 20/20%, kur qeveria thoshte se do të ndihmonte sektorin. Në foltoren e Kuvendit, deputeti i PS-së tha se heqja e kompensimit 6% të TVSH-së dhe taksimi i inputeve do të shkaktojë humbje të mëdha për bujqit.

“Natyrisht që më shkon ta bëj pyetjen se çfarë ka ndodhur me qeverinë që kur e vendosi

këtë skemë dhe sot që e ka bërë zero investimin për fermerin. Problemi është te bujku dhe eksportuesi. Po ju marr një produkt. Një kg ullinj me çmimin 50 lekë, grumbulluesi e mori këtë produkt dhe doli në treg me 60 lekë, e këtu ka 10% TVSH, po të bësh diferencën mes TVSH të kompesuar dhe TVSH në shitje, grumbulluesit i mbeteshin 8.3 lekë për të gjitha. Ai kishte para dhe interes që të grumbullonte produktin e bujkut, pa ushtruar presion e të jetë bujku në tryzni. Nëse shkojmë te zero në 20, humbja është 20 lekë për grumbullues, tha Braçe.

Sipas tij duhen vetëm 2 miliardë lekë për të rimbursuar direkt fermerët për TVSH-në.

“TVSH e inputeve bujqësore, nëse do kishim një treg që funksionon normalisht, çmimet i cakton tregu jo taksa. Por ne në

tregun e inputeve bujqësore nuk kemi rregulla, kemi kartelë të 10 kompanive që përcaktojnë çmimet dhe nëse ne vendosim TVSH 10%, do transmetohet te kosto me të cilën bujku do të blejë çdo gjë. Na duhet të çlirojmë tregun nga karteli i këtyre 10 kompanive dhe të shikojmë normën e taksave që mos e rrisim barrën tani pasi barra e taksës mbi bujkun do rrisë kostot e bujkut dhe do ulë fitimin e tij”, tha ish zëvendëskryeministri.

Gjithashtu Braçe propozoi të bëhet zero taksa për Shqipëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) dhe jo 5% sa është parashikuar në paketën fiskale. Sipas tij taksimi i SHBB-ve nuk favorizon bashkimin e fermerëve, pasi ata individualisht nuk taksohen dhe nuk kanë interes të bashkohen pasi do të taksohen.

Shqipëria merr Presidencën e SWG-së, Krifca: Fermeri në qendër të politikave

Nën kujdesin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u mbajt në Tiranë, takimi i 15-të i ministrave të Bujqësisë së Evropës Juglindore (EJL). Ky takim u zhvillua në kuadër të marrjes së Presidencës së SWG-së për vitin 2022 nga Shqipëria.

Ministrat e Bujqësisë nga

rajonale, por edhe në krijimin e mekanizmeve të duhur administrativ dhe financiar, për të zhvilluar më tej hapësirën rurale.

Në këtë kontekst, ata u dakordësuan mbi rëndësinë e padiskutueshme që mbart politika e përbashkët bujqësore e Bashkimit Evropian (CAP), jo

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, i njohu ministrat me objektivat e Shqipërisë për Presidencën gjatë 2022, duke theksuar prioritetet e kësaj të fundit si Agjenda e Gjellbër, bashkëpunimi Rajonal dhe Evropian, bashkëpunimi ndërkuftar, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave në sipërmarrje.

Gjithashtu, ministria Krifca theksoi se fondet IPARD kanë ndihmuar në transformimin e bujqësisë shqiptare si promotor zhvillimi, formalizimi dhe standardizimi në përfshirimin me BE.

Më tej, diskutimi u ndal edhe tek aplikimi i teknologjisë, duke e vlerësuar si të ardhmen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në të gjitha vendet. Duke vlerësuar rezultatet pozitive të mandatit të Republikës së Serbisë në presidencën e kësaj asambleje, Krifca shprehu vullnetin e plotë të Shqipërisë për të konkretizuar më tej politikat në favor të rritjes së tregtisë rajonale dhe më gjerë.



vendet e EJL theksuan vullnetin e plotë për forcimin e bashkëpunimit mes vendeve, jo vetëm në hartimin e strategjive

vetëm si një katalizator zhvillimi për vendet e BE-së, por edhe për Shqipërinë.

Në fjalën hapëse, ministria e

AKADEMIA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS, SFIDAT E VRESHTARISË

KASH PJESË E SIMPOZIUMIT SHKENCOR “VRESHTARIA DHE VERËTARIA NË HAPËSIRËN MBARËSHQIPTARE.”

Fokus i Simpoziumit është pikërisht konsolidimi i prodhimit cilësor dhe standardizimi i mirëfilltë, marketingu dhe evidentimi më i plotë i verërave shqiptare, për të zënë vendin që u takon në tregun vendas, përtëritja e strategjisë dhe e politikës verëtare në mënyrë që të vihet në kushte të barabarta e madje të privileguara ndaj verërave të huaja

Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarrëshqiptare - Rilindja e tyre duke filluar që nga tradita e ilirëve ishte në fokus të simpoziumit treditor mbajtur në Tiranë, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave e Kosovës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, Instituti Bujqësor i Kosovës, Pejë; Kolegji AAB Prishtinë; Shoqata “Vreshtari” Rahovec, Shoqata e Verëtarëve të Kosovës, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural, Instituti Agronomik Mesdhetar, Valenzano, Bari, Itali, Shoqata e Someliereve të Shqipërisë, Vënaritë prodhuese të Shqipërisë dhe Kosovës.

Teksa, “Gjendja e vreshtarisë dhe e prodhimit të rrushit në Shqipëri dhe çështje të implementimit të legjislacionit përkatës” ishte tema e kumtesës së përgatitur nga Kreu i KASH-it, Agim Rrapaj, përfaqësuesi i shoqatës së verërave, Gazmend Shehi dhe ish zv.ministrja e

Bujqësisë, petagoge në UBT, Vjollca Ibro.

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj në

servimi i hardhive autoktone, krijimi i koleksioneve gjenetike të gjermoplazmës së kultivarëve autoktone të hardhive, përdorimi

dhimit të verës në Europë, zunë një vend të rëndësishëm.

Rrapaj theksoi: “Periudha 1960-1975 konsiderohet si më e

“kriza nga firmat piramidale” gjatë viteve 1991-1997, çoi në prerjen, shkatërrimin apo braktisjen e mbi 17,000 ha hardhi”.

Shqipëri janë Kallmet, Sheshi i zi, Sheshi i Bardhë, Vlosh, etj. Kurse varietetet kryesore të importuara janë Merlot, Cabernet Sauvignon, Chardonnay, Riesling, Petit Verdon. Synimi i politikave në lidhje me vreshtarinë dhe verën është zëvendësimi i importeve dhe kapja e tregut të turizmit. Kjo kërkon përmirësime të cilësisë dhe efikasitetit në prodhimin e fermave me vreshta dhe nivelin e përpunimit të rrushit.

Drejtimet kryesore të punës lidhur me cilësinë lidhen me fidanishtet dhe materialin mbjellës, ku përfshihet identifikimi dhe konservimi i gjermoplazmës së hardhive autoktone, certifikimi i fidanëve të hardhive autoktone, formimi i kloneve të hardhive autoktone, shëndetësimi i fidaneve, sidomos, nga sëmundjet virale. Drejtimet kryesore të punës lidhur me përmirësimin e teknologjive në vreshtari përfshijnë përmirësimin e trajtimeve që nga plugimi dhe punimet e tjera, plehërimi dhe ujitja, kon-

(Vijon në faqen 5)

FED invest - Më shumë shërbime për fermerët, rrisitë teknologjike në sektorin e Mikrofinancës

Ofrimi i shërbimeve financiare dhe jo-financiare përmes platformave digjitale

Mezhvillimineteleknologjive digjitale, shërbimet dhe produktet e pagesave në gjithë botën janë rritur, krahas rritjes së inovacioneve për shërbime të shpejta, të sigurta dhe me sa më pak kosto.

Përfundim këtu nuk bën as Shqipëria, që ka njohur rritje gjatë viteve të fundit, e sidomos gjatë dy viteve të fundit, në kushtet e pandemisë. Është rritur numri dhe përdorimi i kartave të debitit dhe numri i transaksioneve të pagesave online.

Nisur nga nevoja e madhe e popullsisë në zonat rurale për shërbime financiare, përfshirë shërbimin e pagesave, krahas nevojës për hua dhe depozita, FED invest ka ndërmarrë një sërë nismash në vitet e fundit për të modernizuar infrastrukturën e sistemeve dhe teknologjisë, me qëllim ofrimin e shërbimeve të reja financiare dhe jo-financiare.

Numri i transaksioneve online është rritur me hapa galopant, por duhet theksuar se

një pjesë e madhe e qytetarëve nuk kanë akoma akses për të kryer pagesa online apo afër vendbanimit të tyre. Kjo lidhet jo vetëm me historinë e re të ofrimit të shërbimeve bankare për popullsinë, por edhe me sfidat për formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe edukimin e pamjaftueshëm të individëve, për përdorimin e kanaleve digjitale.

FED invest synon të hapë rrugën edhe për shërbimin e pagesave në zonat rurale, ndonëse ka filluar me pagesat utilitare por shumë shpejt në degët e FED invest mund të kryhet çdo pagesë për nevojat familjare. Tani pagesat e energjisë elektrike mund t'i kryeni në të gjithë rrjetin e FED invest, pa komision!

Besueshmëria qëndron në faktin se realizimi i tyre do të ndikojë jo vetëm në formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë e zgjerimin e përfshirjes financiare të zonave rurale, por edhe në krijimin e mundësive të reja

i metodave të biologjisë molekulare për identifikimin e kultivarëve autoktone të hardhive në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe identifikimi i sëmundjeve për t'i mbrojtuar ato synojnë drejt zgjidhjes së problemeve, duke e rilindur dhe zhvilluar më tej traditën e trojeve shqiptare që kanë qenë një nga vatrat më të lashta të kultivimit të hardhive dhe pro-

mira për vreshtarinë tonë, si për nga shtimi i sipërfaqeve ashtu edhe i prodhimit. Në vitin 1980 sipërfaqja e vreshtave arriti në mbi 16 mijë ha. Sipërfaqja e vreshtave në Shqipëri ra me më shumë se 70% midis viteve 1989 dhe 1992, pasi rënia e sistemit u shoqërua nga një dekollektivizim dhe fragmentim rrënjësor të bujqësisë shqiptare. Po kështu,

për ndërhyrjen e mëtejshme të institucioneve dhe agjencive private e publike, në zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale.

Rreth FED invest

www.fedinvest.al

FED invest është kooperativa financiare më e madhe në Shqipëri, me rreth 80 mijë anëtarë, që shërbehen me 61 degë në zonat urbane dhe rurale. FED invest ka hapur rrugën e zhvillimit të mikrofinancës në Shqipëri dhe ka një eksperiencë 29-vjeçare në veprimtarinë e huadhënies, depozitave dhe shërbimeve këshilluese për sipërmarrësit e vegjël dhe fermerët. Sot është institucioni financiar me praninë më të madhe në zonat rurale në vend.

Ky pozicion është në harmoni me misionin e tij, për të zgjeruar përfshirjen financiare të popullsisë në zonat rurale dhe peri-urbane, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh financiare, bazuar në teknologjitë moderne bankare.

KASH pjesë e bizneseve që informohen mbi procesin e integritimit në BE

Këshilli i Agrobiznesit shqiptar (KASH) dhe bizneset shqiptare kanë nevojë të jenë më të informuara mbi procesin e integritimit evropian dhe të rrisin kapacitetet e tyre në këtë drejtim, me qëllim që të bëhen aktor ndikues dhe partner i qeverisë në të gjitha fazat e procesit.

Këto ishin disa nga gjetjet kryesore të studimit “Gatishmëria e bizneseve shqiptare në procesin e anëtarësimit në BE” që u ndërmor nga projekti “Mbështetje për Negociatat në Kapitujt Ekonomikë të BE” - SANECA, financiar nga qeveria gjermane dhe zbatuar nga GIZ dhe i realizuar nga Qendra Shqiptare për Konkurrencën dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT).

“Studimi është i pari, të paktën në 5-6 vitet e fundit, që targeton specifikisht biznesin dhe procesin e integritimit dhe analizon nivelin e njohurive të këtij komuniteti, me qëllim identifikimin e nevojave për rritjen e kapaciteteve,” tha drejtuesja e projektit SANECA, znj. Blerina Raça në prezantimin e gjetjeve. “Impakti i integritimit është

real. Ka kosto dhe përfitime. Studimi është një nismë për të kuptuar në mënyrë të thellë dhe të strukturuar çfarë mendon biznesi. Për qeverinë shqiptare, biznesi duhet të jetë më i përfshirë

dhur midis kostove dhe përfitimeve të procesit, komuniteti i biznesit dhe strukturat qeveritare përgjegjëse për anëtarësimin në BE duhet të jenë partnerë të njëri-tjetrit. Dialogu i hapur dhe



në këtë proces, pasi çdo ndryshim ligjor që vjen në kuadër të integritimit, sjell përfitime, por edhe kosto,” tha Zëvendësiministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Besart Kadia, njëkohësisht negociator i kapitujve ekonomikë për palën shqiptare.

“Për të siguruar ekuilibrin e

(Vijon në faqen 6)

BUJQËSI - BLEGTORI

Fermerët kërkojnë të kalohet në subvencione direkte për prodhimin

Për të përballuar situatën në bujqësi, Sindikata e Fermerëve dhe Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) kërkon të ndryshojë modeli i përdorur deri tani për subvencionimin, duke kaluar nga subvencio-

cilët për disa ditë rresht protestuan në Lushnjë.

Kryetari i Sindikatës të Fermerëve, Eduard Sharka tha për Monitor se këto ndryshime vijnë në një kohë kur të mbjellat janë reduktuar 30%,

sportuese, pasi janë me risk për shkak të kushteve të ekonomisë sonë dhe duhen të mbrohen. Për realizimin e këtyre pikave nuk kërkojmë të marrim fonde nga taksat, por nëpërmjet formalizimit të sektorit. Në bazë

të treguesve të projektbuxhetit 2022 ne parashikojmë që nëse formalizohet bujqësia të ardhurat do të rriteshin 150 mln euro. Një pjesë e të ardhurave që do të mbliidhen nga formalizimi të shpërndahen për fermerët sipas propozimeve tona”, pohon Sharka.

Skema e subvencionimit direkt të fermeri, që kultivon perime të freskëta në bazë të produktit

të hedhur në treg, të justifikuar me fature tatimore, propozohet të jetë e ngjashme me skemën e aplikuar në vitin 2019 për prodhuesit e qumështit, por pa procedurat burokratike të aplikimit dhe konkurrimit në AZHBR dhe pa limit.

Më herët edhe nga Shoqata e përpunuesve të Qumështit u kërkuar 10 lekë subvencion për çdo litër qumësht lope/dele/dhi të dorëzuar nga fermeri në pikat e licencuara të grumbullimit ose fabrikat e përpunimit të qumështit. Sipas tyre skema mbështetëse duhet të jetë pa limit, në mënyrë që çdo fermer ta përfitojë subvencionin për çdo litër qumësht të prodhuar, njëlloj si në rajon.

net indirekte, të cilat kalojnë përmes proceseve burokratike të vështira për fermerët, në subvencione të drejtpërdrejta për prodhimin, nëpërmjet faturave tatimore.

Sindikata e Fermerëve dhe KASH ngritën shqetësimin se vendosja e TVSH-së 10% te imputet dhe heqja e TVSH-së të kreditueshme do të godasë prodhimin vendas.

Heqja e TVSH-së 10% te çmimet e imputeve bujqësore të propozuar me paketën e re fiskale nga zero që është prej 2018 dhe barazimi i skemës të TVSH-së, si në blerje dhe shitje janë kërkesat kryesore ndaj ndryshimeve fiskale. Paketa fiskale 2022 është pritur me shqetësim nga fermerët, të

krahasuar me vjet dhe 90% e sektorit të tregtimit të frutave-perimeve është në informalitet. Sipas tij rritja e taksave do të shtojë kostot prodhuese të gjithë fermerët. Sindikata propozon subvencione direkte për fermerët nëpërmjet faturës tatimore me fond me vlerë 70 mln euro. Në ndryshimet për ligjin e TVSH-së të paketës fiskale që heq TVSH-në 6% të kreditueshme thuhet se kjo skemë do të zëvendësohet me skema subvencionuese në mbrojtje të fermerëve, por ende nuk ka masa të zyrtarizuara.

“Ne kërkojmë subvencione direkte me fond në vlerën 70 mln euro/vit për fermerët e fruta-perimeve; 5 mln euro/vit fonde mbrojtje për bizneset ek-

Rama: 400 milionë dollarë eksporte në bujqësi

Kryeministri Edi Rama deklaroi se rritja e eksporteve në 400 milionë dollarë është shembull kuptimplotë i zhvillimit të sektorit të bujqësisë, ndërsa shtoi: “Duam të shkojmë në 1 miliard eksporte të kombinuara në bujqësi dhe peshkim”.

Gjatë prezantimit të buxhetit 2022 për bujqësinë, Rama tha se rritja e eksporteve në 400 milionë dollarë ishte një shifër e pamendueshme deri 7-8 vjet më parë.

“Atyre që nga smartfoni bëjnë komente që bujqësia ka marrë fund, ju them se e kundërta është e vërtetë. Mjaf-ton të shikojmë faktet dhe jo të humbasim në shifra. Rritja e përvitshme e eksporteve bujqësore tregon vetë, nuk ka nevojë të diskutojmë gjerë e gjatë. Eksportet rriten se rritet prodhimi, rriten kapacitetet grumbulluese dhe kapacitetet tregtuese të vendit”, tha Rama.

Këtu, kryeministri solli në vëmendje edhe dyfishimin e sipërfaqes së tokës së punuar.

“Nga 120 mijë ha që ishte në 2013, sot kemi 255 mijë ha

tokë të punuar në Shqipëri. Pra, punojmë, dyfishin e tokës së

parë në rajon për tërheqjen e fondeve nga BE.



Shqipërisë, sepse kemi investuar fuqishëm duke rehabilituar kanalet ujitëse dhe të kullimit. Po ashtu, kishim diga të tëra të lëna në mëshirë të fatit, ndërsa sot jemi në kushtet kur kemi 40 diga të rehabilituara dhe 80 km argjinatura mbrojtëse të rehabilituara”, tha Rama.

Po ashtu, Kryeministri theksoi se Shqipëria është vendi i

“Të gjitha këto fonde, bashkë me fondet e buxhetit, e bëjnë buxhetin e vitit 2022 të pakrahasueshëm me buxhetin e 2021. Por këto fonde kërkojnë dije. Me fondet e BE-së ne kemi rritur kapacitetin për të financuar bujqësinë. Ishim vendi i fundit në rajon, sot jemi vendi i parë në rajon për tërheqjen e këtyre fondeve”, tha Rama.

“Ballkani i hapur”, treg përtej Shqipërisë për kafshët e gjalla dhe prodhimet blegtorale

Kryeministri Edi Rama deklaroi se në kuadër të “Ballkanit të hapur”, për herë të parë, nga viti i ardhshëm, do të kemi treg përtej Shqipërisë për kafshët e gjalla e për prodhimin e mishit dhe për prodhime blegtorale.

Në prezantimin e buxhetit 2022 për bujqësinë, Rama tha se shteti bën mbështetje dhe bën hapje rrugësh.

“Kjo është një nga përgjigjet për të gjithë ata që ngrihen kundër ‘Ballkanit të Hapur’. Ne kemi arritur tani që për herë të parë, nga viti i ardhshëm, do të kemi treg për kafshët e gjalla e për prodhimin e mishit dhe për prodhime blegtorale përtej Shqipërisë. Deri sot kjo ishte e pamundur. Sot unë ju them që me marrëveshjen që do firmosim në fund të vitit, në hapësirën e Maqedonisë së Veriut, në hapësirën e Serbisë dhe me përfshirjen e të tjerëve në gjithë hapësirën e Ballkanit, do të mund të tregtohet mishi, do të mund të tregtohen prodhimet e mishit dhe prodhimet blegtorale, gjë që është kërkesa numër një e të gjithë atyre që investohen në këtë fushë”, sqaroi Rama.

Sipas tij: “Këtu në Shqipëri kjo është kërkesa numër një për ta rritur këtë sektor. Si do ta stimulojmë ne blegtorinë kur nuk shiten dot jashtë produktet? Nuk ka mundësi! Cila është kërkesa e tyre? “Na hapni rrugët e Lindjes së Mesme”, “na hapni rrugët e Turqisë”, se në BE dihet që do të jetë një histori më vete ajo. Një nga pikat që e ka penguar një prej vendeve që sot është anëtar i Bashkimit Europian me një kohë ekstra për t’u bërë anëtare e BE ishte pikërisht mishi, thertoret, standardet, se nuk të fut njeri në BE nëse nuk i ke këto standarde, por ajo është një kohë tjetër”, shtoi Rama.

Kryeministri theksoi: “Ne duhet të hapim tregje për këta njerëz dhe tregje për këto prodhime dhe pastaj hapja e tregjeve, krijimi i sinergjive sjell rritjen e të ardhurave, sjell rritjen e përfitimit”.

Rama tha se, nuk mund të pretendojmë rritje përfitimi duke ndenjur secili në vete e duke pritur që shteti të vijë e ti japi të gjithëve lekë.

“Bujqësia është pa diskutim në rrugën e duhur, por njëkohësisht sa më shumë ecën në këtë rrugë, aq më e madhe bëhet sfida dhe aq më e madhe bëhet

nevoja për mbështetje”, tha ai.

Ndaj, Kryeministri theksoi: “Ne do t’i japim mbështetje shumë më të madhe me këtë buxhet, krahasuar me të gjitha buxhetet e tjera”.

“Është buxheti më i madh për bujqësinë ky i vitit 2022 dhe është aty për të mbështetur të gjithë ata që punojnë dhe të gjithë ata që e kuptojnë dhe një gjë tjetër, që paratë nuk mund të



të vijnë sikur po hidhen në lumë, por paratë të vijnë duke pasur ti kapacitetin që t’i thithësh ato përmes dy gjërave. E para, të bashkohen”, tha Rama.

Kryeministri shtoi: “Ne nuk mund dot të financojmë tek e tek njerëz, ndaj duhet që të stimulojmë bashkimin”.

“Nuk bëhet fjalë që të bashkohen pronat, bëhet fjalë që të bashkohen forcat. Secili në parcelën e vet. Në momentin që je i bashkuar, negociacioni ndryshe, je në formulën që është A-ja e gjithë kësaj pune. Veç në prodhim, bashkë në shitje. Po ashtu nga fara, tek fidani apo tek kultura që do mbjellin apo pesticidet që do përdorin apo tek të gjithë proceset që do ndjekin, bëjnë të njëjtën gjë dhe është njësoj sikur është një kooperativë e madhe, por në vend se të ardhurat të shkojnë tek një dorë, shkojnë tek të gjitha duart sipas kontributit që kanë dhënë”, sqaroi Rama.

Rama u ndal po ashtu te mbështetja që i është dhënë grumbulluesve.

“Të gjithë atyre që dolën atje për çështjen e rimbursimit të TVSH-së, unë u them shumë thjesht, do takohemi prap vitin tjetër dhe do shikojnë që ata do jenë përfitues më të mëdhenj se deri sot nga çfarë kishin. Ky është fakti, sepse bujqësia do përfitojë më shumë, ekonomia do përfitojë më shumë, punësimi do përfitojë më shumë

e natyrisht kur them punësimi, për ata që duan të punojnë. Nuk e kam takuar akoma sot asnjë sipërmarrës, as në qytet, as në fshat, ja ku janë këtu i të flasin, që nuk kanë vende të lira pune. Të çohet e të thotë a je gati të punësosh të tjerë dhe përgjigja do jetë, jo vetëm jam gati, por ku janë të tjerët sepse rritja e prodhimit kërkon rritje të forcave për sa kohë që ako-

ma ne nuk jemi në fazën që ta humbasim krahun e punës për shkak se teknologjia po na e bën me robot këtë punë, nuk jemi në atë fazë”, tha Rama.

Në përfundim, kryeministri solli shembullin e suksesshëm të një eksportuesi shqiptar në tregjet e huaja”.

“Ja ku është Musai, ai ishte në kushte mbijetese, sot lidh kontratë në Gjermani për të shitur të gjithë vajin e ullirit. Por janë të tjerë akoma në sektorin e përpunimit të ullirit e të vajit që bëjnë të njëjtën gjë. Një nga vajrat më të shtrenjtë në Europë sot të ullirit, është një vaj shqiptar që shitet në farmaci në Zvicër, në farmaci, jo në dyqan. Vaj shqiptar. E ku prodhohet? Prodhohet këtu. E kush e prodhonnë, të vdekurit? Jo e prodhonnë ata, që punojnë dhe që nuk bëjnë lajm, se kur shkon Musai, lidh kontratë me Gjermaninë apo kur sektori i peshkimit, nga një sektor me dy destinacione vetëm, i keqtrajtuar dhe i abuzuar nga ato destinacione dhe nga ato tregje në Itali e në Greqi, sot ka 27 vende e shkojnë prodhimet e detit të Shqipërisë deri në Hong-Kong dhe janë gati tani, shpresoj të mbyllet së shpejti, të futen në tregun më të komplikuar, më të vështirë, më të ngatërruar që është Japonia, nuk bën lajm. Nuk e di njeri. Ama dalin ca njerëz në protestë dhe thonë mbaroi bujqësia, mbushen televizorët”, tha ai.

Rama: Drejt deteve të tjera për rritjen e industrisë shqiptare të peshkimit

Kryeministri Edi Rama u takua me peshkatarë ku dhe u garantoj hapjen e rrugës së peshkimit deri në Senegal dhe Libi.

“Drejt deteve të tjera për rritjen e industrisë shqiptare të peshkimit”, theksoi Rama.

Gjatë bisedës me ta kryeministri tha: “Bëni delegacionin

të shkojmë në Senegal, të takojmë presidentin e Senegalit do diskutojmë që të hapet një korridor për ju që të peshkoni edhe atje. Po ashtu edhe për Libinë u hapim rrugën”.

Në fjalën e tij në prezantimin e buxhetit 2022 për peshkatarët, kryeministri Rama tha: “Vetëm këtë vit presim të mb-

yllet me 32 subjekte më shumë të licencuara në industrinë e peshkimit, kemi 720 subjekte të formalizuara”.

Gjithashtu Rama bëri të ditur se peshkatarët janë bërë faktor në tregun më të vështirë dhe më të pasur të të gjithë kontinentit që është Evropa Veriore e vendet nordike.

BUXHETI PËR BUJQËSINË

Rama me fermerët: Ramë dakord që ndryshimi i qasjes së financimit nga qeveria është i duhuri

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me fermerët e Lushnjës, të cilët protestuan përpara Kuvendit kundër paketës së re fiskale, që pritet të miratohet këtë të enjte.

Kreu i qeverisë theksoi se, “ramë dakord që ndryshimi i qasjes së financimit nga qeveria është i duhuri. Por, kemi dallime për mënyrën e re të adresimit

Ata që hedhin gurin dhe fshehin dorën, kanë marrë mbështetje nga kjo qeveri në vite për ato investime që kanë bërë atje, që të bëjnë pikat e grumbullimit me një financim të përbashkët dhe ndërkohë rolin e agjentit të qeverisë për të çuar diferencën te ju, nuk e kanë luajtur”.

Kryeministri, i cili shpjegoi se ndryshimi i qasjes së financimit

ndihmojnë këta që të mos dalin nën kosto e mos bëjnë nga këto aventurat individuale me instinkt, por të krijojnë bashkime. Kjo është arsyeja pse ne po ndryshojmë qasje, sepse në fund të ditës qëllimi është ta formalizojmë sektorin dhe të dimë kush bën çfarë”, tha Kryeministri.

Kreu i Sindikatës së Fermerëve, Eduard Sharka tha se “fermerët ndodhen në vështirësi të mëdha dhe 30 % prej tyre nuk kanë porositur farat për të mbjellë, për arsye se kanë dështuar për tre vite”.

Fermerët i thanë Kryeministrit Rama se prej 3 vitesh i kanë kërkuar qeverisë shqiptare ndryshimin e formës së subvencionimit dhe heqjen e 6 %. “Në buxhetin e shtetit ky 6 % është vlerësuar 9 milionë dollarë, por nuk është kaq, por pesëfish më shumë”, thanë fermerët.

Në përfundim të diskutimeve, Kryeministri i ftoi fermerët në një takim të dytë, për të shpalosur idetë e tyre se çfarë mund të bëhet më mirë në vijim. “Unë po të jap fjalën këtu që javën tjetër ne ulemi. Kjo ishte e rastësishme. Nëse ju na jepni ide që shkojnë, se me sa kuptoj unë dhe synimi është i njëjtë. Edhe ju nuk po kërkonit të hedhim lekët në ajër. Atëherë hajde të ulemi, nëse ju na jepni ne një ndihmë, me një ide më të mirë se ajo ide që kemi, ne bëjmë idenë tuaj, se nuk kemi asnjë shqetësim për këtë punë. Unë do jem komplet në dispozicion për ta bërë më të mirën me mundësitë që kemi. Rëndësi ka që për këtë bisedë u morëm vesh që kjo, siç ishte, nuk qëndron. Tani urdhëro, të ulemi e të shohim. Te zyra ime do takohemi. Hajdeni me shifra. Përgatituni mirë”, – u shpreh Kryeministri.

Në takimin me fermerët ishin edhe ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj.



dhe për këtë do të takohemi së shpejti me mendje të hapur për të dëgjuar njëri-tjetrin”.

Përgjithësisht, vijon Rama, duhet ta dëgjojmë më shumë njëri-tjetrin dhe ky i sotmi është një shembull pozitiv për të gjithë ata që duan t'i zgjidhin problemet, e jo të bëjnë politikë të ulët me problemet.

Kryeministri tha se, “debatat në Kuvend me një grup fermerësh nga protesta dhe drejtuesin e tyre, kandidat për deputet i PD-së, ishte shumë më konstruktiv e i dobishëm sesa debatet në sallën e parlamentit, ku debatet sundohen nga akuzat, shpifjet e sharjet me natyrë personale”.

Gjatë takimit Rama tha se “të dy palët paskemi të njëjtin hall, ai 6 % nuk shkon te fermerët. Tani, çfarë ka ndodhur? Ne e kemi bërë deri tani dhe do e ndryshojmë, sepse e para, bujqit s'kishin pika grumbullimi.

nga qeveria është i duhuri, gjë e cila do të konkretizohet shumë shpejt, në dobi të fermerëve.

“Unë kam një argument shumë të thjeshtë. Po të ishte se gjendja do ishte uniforme për të gjithë, do thoja që ke të drejtë. Por nuk është uniforme. Sot, ka shifra eksportesh që vetëm rriten. Nga janari, në tetor janë më shumë, sesa janar-tetor 2019-2020. Këtu është çështje organizimi dhe çuarje e parasë në drejtimin e duhur, jo në drejtimet që paraja ka devijuar. Çfarë ka ndodhur? Janë 9 milionë dollarë në një sektor që ka 3,5 miliardë. Për çfarë po protestohet këtu? Për këtë 9 milionë dollarëshin? 9 milionë dollarëshi nuk do të jepet më në atë formë, por nuk do të ikë nga bujqësia. Madje është dyfishi sot, është i dyfishuar, për të shkuar drejtpërdrejt te fermeri. Po si do shkojë te fermeri? Nuk shkon dot tek e tek. Do të shkojë te modelet që i

Sistem mikrosigurimi për fermerët në raste fatkeqësish natyrore

Fermerët shqiptarë do të kenë së shpejti sistemin e tyre të sigurimit të prodhimeve në rast të fatkeqësive natyrore.

Kryeministri Edi Rama deklaroi se po punohet për një sistem mikro-sigurimi, që t'i kushtojë në minimum prodhuesit dhe fermerëve dhe që djersa e tyre të mos shkojë kot në raste fatkeqësish.

“Po mundohemi që bashkë me universitetin, përmes teknologjisë, ta çojmë në një nivel tjetër gjithë procesin e sigurimit të prodhimeve dhe njëkohësisht të cilësisë së prodhimeve. Është e domosdoshme që bujqësia të përfshihet në skemën e sigurimeve. Ta sigurojnë fermerët, ta sigurojnë prodhuesit prodhimin e tyre dhe jo të gjenden përballë befasive të motit, krejtësisht të shkatërruar e pastaj të dalin në rrugë e t'i kthe-

hen qeverisë “duam lekët”. Nuk funksionon kështu”, tha Rama.

Nga ana tjetër, ai shtoi: “Nuk mund t'i themi dot fermerëve, prodhuesve në bujqësi që të sigurohen siç sigurohen ata që sigurojnë makinat, sepse bëhet fjalë për një sistem sigurimi që është shumë i shtrenjtë për prodhuesit dhe për fermerët”.

“Na duhet një sistem sigurimi krejtësisht i ndryshëm e ne po punojmë për këtë, që të kemi një sistem mikrosigurimi, pra që t'i kushtojë në minimum të minimumit fermerit, t'i kushtojë në minimum të minimumit prodhuesit e në momentin kur i vjen katastrofa, ai të jetë krejtësisht i mbuluar. Pra është një minimum i minimumit që pastaj sjell garancinë që asnjë pikë djersë nuk të shkon kot dhe një sistem sigurimi i kombinuar me teknologjinë”, tha ai.

“Sot, vijoi Rama, bota e kontrollon cilësinë dhe garancinë e produktit me satelit, nuk e kontrollon me inspektorë”.

“Ky është një tjetër komponent që do të mbulojnë satelitët tanë. Pra, do punojmë për këtë sistem sigurimi me mikrofiancimin, i cili të garantojë një informacion të plotë, qoftë për qeverinë, qoftë për universitetin, qoftë për siguruesit, qoftë për bujqit dhe për çdo parcelë, që ta dimë në kohë reale në çdo parcelë se ku gjente prodhimi e mbi të gjitha, në kohë reale që në sekondën e parë të identifikohet cilësia e farës sepse aty është një tjetër hall i madh i joni i përbashkët dhe aty përsëri universiteti do të duhet të futet si hallkë garancie në mënyrë që të mos ketë më mundësi që t'u shiten fermerëve fara tjetër për tjetër apo fidanë tjetër për tjetër”, tha ai.

Buxheti 2022, Krifca: 7.1 miliardë lekë mbështetje dhe investime në bujqësi

Së bashku me kryeministrin Edi Rama, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, prezantoi buxhetin për fermerët për vitin 2022.

Në fjalën e mbajtur prej saj, Krifca vuri në pah edhe një herë mbështetjen e qeverisë ndaj këtij sektori, duke bërë me dije prioritetet e këtij buxheti për bujqësinë, si garantimi i sigurisë ushqimore, rritja e eksporteve, qëndrueshmëria e turizmit rural, digjitalizimi dhe inovacioni.

“7.1 miliardë lekë shkojnë për mbështetjen dhe investimet për zhvillimin rural”, tha Krifca në fjalën e saj.

Gjithashtu, ministria informoi se rritja e eksporteve synohet të arrihet nëpërmjet nxitjes së produktivitetit, duke mbështetur dhe financuar rritjen e sipërfaqes së serave, fuqizimin e fermave të mëdha, forcimin e agropërpunimit, rritjen e mekanizimit dhe teknologjitë inovative.

Sipas Krifcës, skema kom-

bëtare e mbështetjes do të dyfishohet vitin e ardhshëm dhe do të përmbajë prodhim të qumështit, perime në serra, bimë mjekësore dhe aromatike, ferma organike.

Më tej, Ministria shtoi se buxheti i vitit të ardhshëm do vazhdojë t'i mbështesë fermerët me naftë dhe do të shtojë kulturën e ullirit. Ajo tha se është shumë i qartë edhe prioriteti për sigurinë ushqimore dhe se fondet na lejojnë të investojmë në kapacitete monitorimi, në përmirësimin e analizave dhe akreditime të reja laboratorike, në gjurmueshmëri dhe higijenë.

Në vitin 2022, ministria tha se do të fillojë zbatimin Programi IPARD II, me një buxhet total prej 146 milionë euro. Këtu Krifca përmendi disa risi për bujqësinë siç janë mbështetja dhe prodhimi i bimëve medicinale, ulliri, peshkimi dhe përpunimi i tyre, sektor që nuk mbështetej më parë nga IPARD.

“Gjithashtu, nëpërmjet IPARD do të shtojmë pesë masa të reja mbështetje që përfshijnë pyllëzimin, infrastrukturën rurale, shërbimet e këshillimit masat ndaj ndryshimeve klimatike dhe fermat organike”, u shpreh ministria.

Me fokus te dija, si i vetmi mekanizëm i zhvillimit, do të ndihmohen fermerët me informim dhe këshillim me një buxhet të dedikuar prej 634 milionë lekësh.

“Do të financojmë projekte për bujqësi të digjitalizuar, me vlerë rreth 103 milionë lekë, që do të ndihmojnë në ngritjen e regjistrave të fermës, të sistemeve të aplikimeve online, duke ulur barrën për aplikantët dhe rritur transparencën”, vijoi Krifca në fjalën e saj.

Krifca përfundoi duke shprehur angazhimin total dhe bashkëpunim të plotë në shërbim të zhvillimit, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Protesta të fermerëve, Krifca: Disa kërkesa të adresuara në buxhetin 2022

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se, kërkesat e fermerëve për paketën fiskale janë të adresuara mjaft mirë në buxhetin e vitit 2022.

Në konferencën për mediet pas mbledhjes së qeverisë, Krifca iu përgjigj interesimit për protestën e fermerëve të Lushnjës dhe nëse ka pasur një reagim nga qeveria për kërkesat e tyre.

Ministria informoi se është në dialog të vazhdueshëm me fermerët.

“Kam qenë në Lushnjë, në pikat e grumbullimit, kam takuar fermerët dhe dialogu nuk ka munguar asnjëherë. Ata kanë disa pretendime për paketën fiskale, që janë të adresuara në fakt mjaft mirë në buxhetin e vitit 2022, që vijnë si masa direk-

te mbështetëse për fermerët për rritjen e produktivitetit në bujqësi, që është dhe objektivi kryesor i qeverisë për të pasur sa më shumë eksporte dhe mirëqenie”, deklaroi Krifca.

“Jemi në dialog të vazhdueshëm, jemi në një barrikadë dhe jemi në të njëjtin kah, dhe duam të kemi një bujqësi më të qëndrueshme”, tha ajo.

KASH pjesë e simpoziumit shkencor “Vreshtaria dhe verëtaria në hapësirën mbarëshqiptare.”

(Vijon nga faqja 3)

trolli i sëmundjeve dhe dëmtuesve, krasitjet, kujdesi gjatë dhe pas vjeljes së prodhimit. Ndryshimet klimatike do të kërkojnë një përgjigje adekuate edhe përsa u takon praktikave në fermë. Për sa më sipër, bashkëpunimi me universitete dhe institute kërkimore për trajnime dhe këshillime është i domosdoshëm.

“Nga ana tjetër, theksoi Rrapaj, performanca e sektorit të vreshtave dhe verërave varet edhe nga përmirësimi dhe zbatimi i legjislacionit përkatës, shtimi i investimeve, përmirësimi i aftësive të prodhuesve etj.”

Ekspertët e fushës vunë theksin në hartimin e legjislacionit mbi vreshtat dhe verën si pjesë e procesit të përafrimit me rregulloret respektive të BE-së.

Në këto akte ligjore detajohen kriteret për përcaktimin e origjinës dhe emërtimi i verërave, llojet e verës të përshtatshme për konsum njerëzor, karakteristikat përkatëse, nënproduktet e verës etj. Zbatueshmëria e Ligjit Nr. 8443, ka hasur në disa probleme për shkak të specifikimeve të kufizuara dhe elementeve të

vjetëruara në të. Kështu, ndryshimet e herëpashershme në strukturat e ministrive që mbulojnë bujqësinë, nuk lejojnë të jetë e qartë përgjegjësia e organit apo njesisë që mbulon vreshtat dhe verërat. Aktualisht edhe pse Neni 3 thekson se “strategjia për zhvillimin e vreshtarisë bazohet në zonimin e bërë nga organet e autorizuar brenda MBZHR-it” ky zonim nuk është përcaktuar. Neni 20 përshkruan Emërtimet e Origjinës në Vresht, por nuk është e mundur të zbatohet për shkak të mungesës së zonimit të varieteteve të kultivuara në Shqipëri. Neni 26 përcakton se “MBZHR organizon dhe mban regjistrin e vreshtave dhe industrisë së verës”. Për shkak të mangësive në mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit, aktualisht ai është pothuajse i papërdorshëm. Nga ana tjetër, të dhënat nuk janë të besueshme edhe për shkak të ndryshimit të përdorimit të tokës, plantacioneve të reja dhe ndryshimit të përbërjes varietore brenda plantacioneve. Një projekt ligj për vreshtarinë dhe verërat është në diskutim publik dhe shoqatat e agrobiznesit dhe më gjerë janë përfshirë në diskutimet për plotësimin dhe

përmirësimin e tij, para se të kalojë për miratim.

Strategjia Ndërsëktoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 thekson: “Sektori shqiptar i prodhimit të verës mund të shfrytëzojë mundësi të reja për të rritur kërkesën e brendshme për verëra cilësore, nëse mbështetet me investime në përmirësimin e cilësisë, modernizimin e teknologjive, pajisje si rezervuarët e ruajtjes, të fermentimit dhe pajisjet laboratorike, duke synuar zhvillimin e verërave cilësore bazuar në varietetet e rrushit lokal/autokthon”.

Rendimenti i prodhimit të rrushit në vreshta 6 vitet e fundit ka rezultuar rreth 114 kv/ha. I pjergullave rreth 13kg/rrënjë. 2/3 e prodhimit të rrushit përdoren për konsum të brendshëm dhe vetëm 1/3 tregtohet.

Prodhimi i rrushit në vendin tonë nga 184.5 mijë ton në vitin 2010, është rritur në 205.1 mijë ton deri në 2016. Skemat e subvencionimit dhe fondet IPARD i kanë dhënë një shtytë rritjes prodhimit të rrushit dhe përpunimit të tij.

Në periudhën 2016 -2020, prodhimi ka pësuar një rënie nga 205.1 mijë ton në 199.1 mijë ton.

PESHKIM

Eksportet në industrinë e peshkimit, rritje me 239%

Kryeministri Edi Rama deklaroi se eksportet në industrinë e peshkimit janë rritur me 239%.

Në fjalën e tij në prezantimin e buxhetit 2022 për peshkatarët, kryeministri Rama tha se vetëm këtë vit presim të mblyllet me 32 subjekte më shumë të licencuara në industrinë e peshkimit, kemi 720 subjekte

marrëdhënia e qeverisë, imja personalisht dhe e drejtuesve të sektorit me gjithë komunitetin e peshkatarëve ka qenë kyç për të kuptuar se cilat kanë qenë problemet më të nxehta dhe për t'i zgjidhur ato. Ishte një shqetësim i përgjithshëm i të gjithëve ju, luftë për mbijetesë në kushtet e një braktisjeje

“Sot eksportohet në Itali, Greqi, Spanjë, Suedi, Norvegji, Kroaci, Etoni, Danimarkë, Rumani, Gjermani, Holandë, Hong Kong, në vendet e rajonit, Kosovë, Serbi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe kulmi i kulmit në proces për të hapur tregun më elitare, më të vështirë, të pasur të peshkut që është Japonia”, nënvizoi Rama.

Rama bëri të ditur se peshkatarët janë bërë faktor në tregun më të vështirë dhe më të pasur të të gjithë kontinentit që është Europa Veriore e vendet nordike.

Kreu i qeverisë u shpreh: “U them atyre që e shohin Shqipërinë e punës nga portalet, kanalet e rrjetet sociale, që paga më e ulët që ju jepni për të punuar në peshkim është 800 mijë lekë”.

“Të gjithë kanë nevojë për punëtorë peshkimi, kjo është ekonomi që po rritet dhe do vazhdojë të rritet. Ku i gjeni punëtorët? Me 800 mijë lekë paga më e ulët, në Turqi, Egjipt, vijnë nga Turqia e Egjipti për të punuar në Shqipëri dhe disa me diploma “Kristali” që pretendojnë se janë juristë kërkojnë punë, s’ka punë. Ja të vijnë dhe të trokasin në dyert e industrisë së peshkimit dhe nëse janë gati të punojnë e kanë gati punën këtu”, tha Rama.



të formalizuara.

Kryeministri Edi Rama tha: “Peshkimi është një nga sektorët ku ka shumë për të thënë, për të bërë, por patjetër ka dhe shumë për të treguar. Kur kemi ardhur këtu për herë të parë në një prej takimeve që kemi bërë gjatë gjithë kësaj periudhe,

totale nga shteti, në një det të hapur ku të gjithë ju niseshit për ta marrë naftën në Itali, ku justifikohet kjo çmenduri me akuzën mbi ju që bënit kontrabandë naftë”.

Sipas Ramës, kjo situatë reflektonte vetëm dy destinacione për eksport, Itali dhe Greqi.

Buxheti për peshkimin, Krifca: Rinovojmë flotën, rrisim eksportet

Së bashku me kryeministrin Edi Rama, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, prezantoi buxhetin për peshkimin për vitin 2022.

Ministrja Krifca në fjalën e saj vuri në dukje mbështetjen e qeverisë ndaj këtij sektori, i cili ka marrë hov zhvillimi të dukshëm që prej vitit 2013 e që është reflektuar edhe në raportin e Komisionit Evropian të këtij viti.

Duke u ndalur tek buxheti i 2022, Krifca bëri me dije se nëpërmjet Programit “Mbështetje për peshkimin” do të vihen në dispozicion 702 milionë lekë.

Gjithashtu, Ministrja informoi se do të mundësohet rritja e kapaciteteve ankoruese të portit të Durrësit, për të ako-

moduar në mënyrë të sigurt flotën më të madhe në vend që përben 60% të totalit. Por jo vetëm, sipas Krifcës, investime do të kryhen edhe në rritjen e kapaciteteve ankoruese në portin e Shëngjinit, në rristurimin e qendrës shtetërore të Zvezdës në Korçë, si dhe do të vihet në dispozicion skema kombëtare e mbështetjes për të vazhduar me rinovimin e flotës së peshkimit.

Më tej, ministrja u ndal tek potenciali që ka vendi ynë tek eksporti i aqugeve. Sektor për të cilin, janë nisur negociatat me Bashkimin Evropian për rritjen e kuotave të aqugeve të përpunuara.

Janë 28 fabrika të përpunimit që kanë autorizim për

eksport në BE. Nga kjo rritje, sipas Krifcës, parashikohet se impakti direkt do të jetë rritja me 4000 persona të punësuar në këtë industri.

Gjithashtu, ministrja shtoi se akuakultura përfaqëson një sektor të rëndësishëm dhe zotëron një potencial të madh.

“Prodhim i përgjithshëm nga uji i ëmbël, uji i njelmët dhe mjedisi detar, është rritur gjatë viteve të fundit, nga 3450 ton në vitin 2012, në 8799 ton në vitin 2020”, vijoi prezantimin Krifca.

Krifca përfundoi fjalën e saj duke shprehur angazhimin maksimal të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të asistuar në çdo nevojë që paraqet ky sektor.

Rama: 41 milionë euro fonde nga BE në dispozicion për peshkimin

Kryeministri Edi Rama deklaroi: “Janë 41 milionë euro në dispozicion për t’u disburuar me fondet e Bashkimit Evropian, ku ne kemi arritur të fusim tani peshkimin”.

Në fjalën e tij në prezantimin e buxhetit 2022 për peshkatarët në Durrës, kryeministri Rama theksoi: “Ishte problem shumë i madh përfshirja e sektorit tuaj”.

“Ju i dini shumë mirë arsyet, ju jeni potencial konkurrues shumë i rëndësishëm dhe kjo është një çështje influencash

dhe interesash. Duke qenë se industria e peshkimit është ngritur në një nivel tjetër dhe ajo e përpunimit ishte jo e lehtë për ta futur në programet e mbështetjes që kryesisht janë programe që mbështesin sektorë të bujqësisë, ku ka nevojë për të krijuar bazën”, u shpreh ai.

Duke iu drejtuar peshkatarëve në Durrës, Rama tha: “Ministrja ka arritur që 41 milionë euro të jenë në dispozicion tuaj gjatë këtyre viteve që kemi përpara. 2022 fillon. Këtu

duhet të jeni ju të gatshëm për të thithur fonde sepse duhen projektet, për të rritur kapacitetet përpunuese, ambalazhuese, komerciale dhe kuptohet me standardet e BE-së”.

Kreu i qeverisë theksoi: “Fillojmë portin e peshkimit në Vlorë që do të jetë 100% me standarde profesionale me kushte-higjieno sanitare dhe me logjistikë si në portet e BE-së. Më vjen keq për ju durrakët, por ai porti i ri peshkimit në Vlorë do jetë më i mirë se ky”.

Universiteti Bujqësor i Tiranës, njehsim i diplomës me atë të Vjenës

Kryeministri Edi Rama deklaroi: “Universiteti Bujqësor i Vjenës po bashkohet me Universitetin tonë Bujqësor për të filluar një proces konvergjimi deri në njehsimin e diplomës”.

Gjatë prezantimit të buxhetit 2022 për bujqësinë, Rama tha: “Ne duam të hyjmë në një fazë të re për sa i përket dijës dhe për sa i përket rritjes së kapaciteteve në aspektin e dijës të njerëzve të sektorit”.

“Një nga universitetet më të vjetër e më me prestigj i Europës, Universiteti Bujqësor i Vjenës po bashkohet me Universitetin tonë Bujqësor, për të filluar një proces konvergjimi deri në njehsimin e diplomës, që të vijë në Universitetin Bujqësor nxënësit shqiptarë, por dhe të tjerë, edhe austriakë dhe të studiojnë e në fund të dalin me diplomën e Vjenës. Ndërkohë që, qysh tani ka filluar puna për programe të përbashkëta e ndërkohë i gjithë koncepti i revolucionarizimit të universitetit po ndërtohet bashkërisht me kolegët e profesorit këtu, atje në Vjenë”, tha Rama.

Sipas tij: “Bujqësia është dije në radhë të parë dhe në këtë botë që transformohet çdo ditë falë teknologjisë, është e domosdoshme që ne të krijojmë një proces ndërvëprimi mes vatrës së dijës që është universiteti dhe gjithë sektorit, por dhe institucioneve që janë në mes, të cilat kanë një problem të madh në këtë aspekt”.

Rama tha: “Kemi nisur prej vitesh tanimë një partneritet, ku ne kemi dhënë mbështetje, por duke filluar nga çlirimi i universitetit fizikisht”. “Universiteti ishte marrë peng fizikisht, nga lloj-lloj grabitësish e nga lloj-lloj abuzuesish që i kishin hyrë në territor dhe që e kishin kthyer territorin e universiteti bujqësor

në një tokë pa zot, duke bërë aktivitete nga më të ndryshmet aty, tregtare, ekonomike, duke banuar aty brenda e duke bërë çudira aty që nuk kishin lidhje fare me universitetin. Universiteti kishte humbur komplet të gjithë infrastrukturën e vetë mbështetëse që ka të bëjë me laboratorët, që ka të bëjë me të gjithë sistemin



eksperimental, që ka qenë një model në të shkuarën. Universiteti kishte humbur komplet në mes të llozhurave dhe të karakatinave atje”, tha Rama.

Ndërkohë, kryeministri shtoi se sot, universiteti është në një fazë ku është çliruar fizikisht, por ka nevojë shumë akoma që të çlirohet nga barrat e mëdha të trashëguara në këto vite.

“Duhet të çlirohet nga një barrë kryesore që është paragjykimi ndaj universitetit për shkak se duket se po të shkosh të studiosh në Universitetin Bujqësor, studion pa një perspektivë punësimi e pa një perspektivë përfitimi. Është komplet e gabuar, është komplet mbrapsht sepse e kundërta është e vërtetë. Në këtë sektor do të ketë nevojë gjithmonë e më shumë për njerëz të ditur, do të ketë nevojë gjithnjë e më shumë për specialistë, për ekspertë dhe do të jetë gjithmonë e më shumë një zonë

e ekonomisë, ku do të mund të bëhet sukses financiar, duke qenë eksperti i duhur, duke pasur strukturën e duhur”, tha ai.

Nga ana tjetër, kryeministri shtoi: “Ne duam që në këtë fazë të fillojmë procesin e trajnimit edhe të testimit të kapaciteteve tona, të kapaciteteve të drejtorive të bujqësisë dhe të gjithë

strukturave të tjera, në bashkëpunim me Universitetin”.

“Nuk është e mundur që ne t’i qëndrojmë pranë me cilësinë maksimale e me të gjithë efikasitetin e duhur fermerëve dhe gjithë këtyre modeleve të suksesshme që kanë nevojë për më shumë mbështetje, me njerëz që janë aty dhe që e kanë rendimentin në punë minimal, për të mos thënë zero. Kështu që i gjithë sistemi ynë, që është sistem ndërlidhje mes qeverisë, shtetit dhe fermerit e realitetit të ekonomisë bujqësore, duhet të jetë një sistem që ne do ta ndërlikojmë me Universitetin Bujqësor e që nga drejtorët e bujqësisë, deri tek specialistët e bujqësisë në të gjithë aspektet e punës së tyre, duhet të marrin trajnime nga universiteti e duhet të testohen nga universiteti nëse janë në lartësinë e duhur për të vazhduar të bëjnë punën”, tha ai.

KASH pjesë e bizneseve që informohen mbi procesin e integritetit në BE

(Vijon nga faqja 3)

gjermane në Tiranë, znj. Judith Hoffmann.

Të pranishëm në prezantimin e gjetjeve, ishin përfaqë-

sues të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë shqiptare dhe të huaja, përfaqësues të shoqatave të biznesit, si dhe përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për përgatitjen e procesit të

bisedimeve për anëtarësim.

Projekti SANECA po mbështet Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në përgatitjet e bisedimeve për anëtarësim në kapitujt 1, 3, 20 dhe 28.

Për herë të parë fond mbështetës për riparimin e anijeve të peshkimit

Peshkatarëve do t’u japë mbështetje të drejtpërdrejtë fi-

nanciare për fuqizimin e flotës dhe riparimin e anijeve.



Gjatë prezantimit të buxhetit 2022 për peshkatarët në Durrës, kryeministri Edi Rama tha sot se “për problemin tuaj të fuqizimit të flotës dhe financimit të riparimit të anijeve ne do ju japim mbështetje të drejtpërdrejtë financiare në dy drejtime. Nga një anë, për herë të parë do të ketë një fond Ministria e Bujqësisë për këdo që thotë unë kam nevojë të riparoj anijen. Do të japim jo kredi, por lekë në dorë, jo borxh, lekë në dorë mbështetje dhe

(Vijon në faqen 10)

TEMA TË DITËS

Hapja zyrtare e “Javës së Bregdetit Mesdhetar dhe Strategjive Makro-Rajonale”, ngjarja kryesore rajonale e vitit 2021, për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mjedisin

Me hapjen zyrtare, ku ishin të pranishëm 100 pjesëmarrës nga të gjitha vendet anëtare të EUSAIR dhe jashtë saj, u zhvillua online edicioni i 6-të i “Javës së Bregdetit Mesdhetar dhe Strategjive Makro-Rajonale”. Ky aktivitet organizohet në dy periudha kohore, nga data 9 - 11 dhe nga data 22 - 23 nëntor dhe për herë të parë u organizua nga Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut së bashku. Nga fillimet modeste të një eventi vendas, është shndërruar në një event evropian me profil të lartë, duke u fokusuar në temat përkatëse si të vendeve anëtare të BE-së, edhe të vendeve joanëtare për çështje si (politika, inovacione, projekte kryesore, çështje mjedisore, etj.) në rajon. Vetë ky event synon të rrisë ndërgjegjësimin për detin dhe brendësinë e tij, potencialin natyror dhe ekonomik për të cilin krenohet dhe ravijëzon rreziqet si rezultat i fenomeneve natyrore dhe aktiviteteve njerëzore. Ky event mbledh bashkëpolitikanë, vendimarrës, ekspertë, shoqërinë civile dhe publikun e interesuar nga të gjitha nivelet si vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Siç theksoi Andreja Jerina, Koordinatorë Kombëtare për Strategjitë Makro-Rajonale të BE-së në Slloveni, nga Ministria e Punëve të Jashtme, anëtare e Bordit Drejtues të EUSAIR dhe Presidencës së Trios së EUSAIR, dhe Zuica Zmejkovska, Zëvendëshefe e Sektorit për Koordinimin e Fondeve Evropiane dhe Asistencave të tjera të Huaja dhe Koordinimit Kombëtar EUSAIR për fondet e BE-së, në kuadër të Sekretariatit për Çështje Evropiane në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë konferencës për shtyp para hapjes zyrtare: Ky event i përbashkët sjell një dimension krejtësisht të ri, një shtet anëtar i BE-së dhe një shtet joanëtar i BE-së, së bashku për organizimin e përbashkët të eventeve, diskutimeve

serioze dhe shkëmbimeve të mendimeve, duke forcuar lidhjet ndërmjet vendeve evropiane. Kjo nuk do të ishte e mundur pa rolin e domosdoshëm lehtësues të EUSAIR Facility Point, si në zyrën e qeverisë për politikën e zhvillimit dhe kohezionit ashtu edhe në Izola. Kjo është arsyeja pse strategjitë makro-rajonale të BE-së njihen si laboratorë për Evropën e re. Ne jemi gjithëpërfshirës, ne ndërtojmë besimin e ndërsjellë, jemi të orientuar drejt së ardhmes dhe sjellim progres në rajon, në terren, si dhe tek njerëzit.”

Folësit kryesorë gjatë hapjes zyrtare nënvizuan rezultate konkrete të strategjive makro-rajonale dhe theksuan se pa bashkëpunim nuk ka zgjidhje të përshtatshme dhe nuk ka të ardhme të përbashkët (pikat kryesore nga fjalimet e tyre):

Kalinka Gaber, Sekretare e Shtetit, Sekretariati për Çështjet Evropiane, Maqedonia e Veriut

“Eventi i këtij viti është një tregues i një miqësie afatgjatë dhe një bashkëpunimi të fortë ndërmjet Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, ky takim është një hap më tej për të treguar përkushtimin e vendeve të EUSAIR, me synim nxitjen dhe përforcimin e lidhjeve të bashkëpunimit të ndërsjellë, ku vendet anëtare të BE-së dhe vendet që nuk janë ende pjesë e familjes së BE-së, qëndrojnë në drejtpeshim të barabartë. “Dimensioni i ri” që synon të sjellë Java e këtij viti, lidhet me vëmendjen që do të donim t’i kushtonim pjesëve pa dalje në det të makrorajonit të Adriatikut dhe Jonit, duke u mbështetur në ndërgjegjësimin e mëparshëm për detet dhe vi-

jat bregdetare që ky event ka adresuar. Jam e sigurt se diskutimi në të gjitha takimet e parashikuara në kuadër të Javës së Bregut të Mesdheut dhe Strategjive Makro-Rajonale 2021 do të jetë frytdhënës dhe më e rëndësishmja, do të sjellë përfitimin më të nevojshëm për njerëzit e rajonit.

Gašper Dovžan, Sekretar i Shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme, Slloveni

“Është thelbësore që brenda makrorajonit, ne të veprojme në mënyrë të organizuar dhe në harmoni. Vendet tona mund të zhvillojnë dhe zbatojnë së bashku projekte shumë më të mëdha dhe me kosto efektive se sa me mjete individuale. Por të kuptuarit e thelbit të bashkëpunimit makrorajonal dhe rritjes së ndërgjegjësimin të atyre që ende nuk i njohin makrorajonet dhe potencialin e tyre, është baza për punë efektive dhe rezultate të prekshme në detyrat operative. Një parakusht për një veprim të tillë efektiv është qeverisja adekuate e EUSAIR-it. Ne shohim përpjekje në strategjitë e tjera makrorajonale në të cilat Sllovenia merr pjesë, për të krijuar dhe siguruar stabilitetin e strukturave të tyre mbështetëse të qeverisjes. EUSAIR ka tashmë një instrument të tillë në Facility Point. Do të doja të shfrytëzoja këtë rast për të shprehur vlerësimin tonë për rolin e domosdoshëm të Facility Point për funksionimin efektiv, qeverisjen e përfortuar dhe vizibilitetin e EUSAIR dhe rolin e saj në organizimin e këtij eventit.”

Senad Oprašić, Koordinator i Grupit Drejtues Tematik për Cilësinë e Mjedisit, Bosnje dhe Hercegovinë

“Ne jemi të lumtur që

Maqedonia e Veriut është me ne për të kompletuar rajonin EUSAIR dhe për të promovuar bashkëpunimin në procesin e integritetit në BE. Të gjitha këto aktivitete do të ndihmojnë vendet e EUSAIR jo anëtare të BE-së të njohin rëndësinë e zonave të mbrojtura dhe planifikimit hapësinor. Është e një rëndësie të madhe që përfaqësuesit e vendeve të EUSAIR do të adresojnë problemet e tyre kryesore që duhet të zgjidhen në bashkëpunim të ngushtë me vendet e tjera të EUSAIR. Përpara na presin shumë procese, si Agjenda e Gjellbër për Vendet e Ballkanit Perëndimor me 5 shtylla – 1. Klima, energjia, lëvizshmëria, 2. Ekonomia rrethore, 3. Çndotja, 4. Bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit dhe 5. Biodiversiteti.

Në këtë pikëpamje, dëshiroj të ftoj BE-në për mbështetje në hartimin e projekteve, që do të jenë çështje kyçe për zbatimin e Agjendës së Gjellbër për vendet e Ballkanit Perëndimor (jo anëtarë të BE-së). Mbështetja do të shihet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë, aksesit në njohuri, si dhe aksesit në informacion, që është detyrë e EUSAIR Facility Point, për ta ndarë atë në proceset e zbatimit të aktiviteteve tona, për të rritur lidhjen e Gjellbër dhe Blu, që do të na ndihmojë në procesin e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor. Do të jetë një lajm i mirë për rajonin që BE të nisë negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Puna e përbashkët është një hap përpara në këtë drejtim.”

Aleksej Skok, Nënkretar, Bashkia e Izolës, Slloveni

“Ne jemi vërtet të nderuar që mirëpresim Javën e Breg-

detit Mesdhetar dhe Strategjive Makro-Rajonale për të gjashtin vit radhazi në kuadër të projektit Interreg Adriatic Facility Point. Kjo e fundit ka përbushur më së miri pritshmëritë e qytetarëve të Izolës dhe tashmë është një nga praktikatat më të mira të bashkëpunimit ndërmjet niveleve lokale, kombëtare dhe evropiane. Ne marrim pjesë që në fillim në projektet progresive makrorajonale, pasi ato pasurojnë kulturën e bashkëpunimit dhe të bashkëjetesës. Mënyra e vetme për t’iu përgjigjur në mënyrë serioze sfidave moderne, qofshin ato mjedisore, detare, transporti apo turistike, është kalimi i kufijve ndërmjet bashkive, rajoneve dhe vendeve. Ky event është një shembull i shkëlqyer i përgjigjes ndaj sfidës së përmendur më parë dhe nuk është vetëm ndërmjet Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut, Lubjanës dhe Shkupit; aty janë edhe Izola dhe Ohri dhe shumë qytete dhe qytetarë të të dy vendeve. Gjithashtu, ne jemi të bindur se rezultati nuk duhet të matet vetëm me kapacitetin financiar. Ka shumë faktorë të tjerë “të butë”, si shkëmbimi i njohurive, praktikatat e bashkëpunimit dhe veçanërisht marrëdhëniet e ngushta ndërmjet vendeve anëtare të BE-së dhe atyre që do të donin të anëtarësoheshin. Në projektet tona, ne shpesh e jetojmë procesin e zgjerimit shumë përpara realizimit të tij politik në të ardhmen.”

Pas hapjes zyrtare të Javës së Bregdetit Mesdhetar dhe Strategjive Makro-Rajonale ditën e mërkurë, më datë 10 nëntor, dy seminare do të pasojnë të nesërmen, “EUSAIR – Si mund të përfshijmë potencialet e inovacionit rreth pro-

jekteve kryesore” dhe “Pikat e referimit të politikave të inovacionit në rajonet makro të BE-së/pellg detar”. Në pjesën e dytë, më 22 nëntor, Maqedonia e Veriut do të organizojë “Takimin ndërmjet zbatuesve kryesorë të EUSAIR dhe autoriteteve programore”, si dhe “Tryezën e rumbullakët me temë: Rinia dhe mbrojtja e mjedisit”.

Ju mund të gjeni informacion për programin e Javës së Bregdetit Mesdhetar dhe Strategjive Makrorajonale duke klikuar në këtë link.

Mbi strategjinë e EUSAIR

EUSAIR është një strategji e BE-së për rajonin Adriatik dhe Jon, i cili adreson sfidat e përbashkëta të rajonit dhe forcon angazhimin e palëve të interesuara për kohezionin ekonomik, social dhe territorial. Strategjia u miratua nga Komisioni Evropian në vitin 2014, duke e bërë atë strategjinë e tretë makro-rajonale në BE që përfshin nëntë vende: Greqi, Kroaci, Itali, Slloveni, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal i Zi, Serbi dhe nga viti 2020 edhe Maqedoninë e Veriut. Ai bazohet në katër shtylla tematike: rritja blu, lidhja e rajonit, cilësia mjedisore dhe turizmi i qëndrueshëm. Sllovenia, së bashku me Bosnje-Hercegovinën, koordinon shtyllën e “Cilësisë së Mjedisit”, ndërsa Bashkia e Izolës si partner slloven i projektit “EUSAIR Facility Point” kryen detyrat e sekretariatit për këtë shtyllë. Objektivat janë përmirësimi i cilësisë së jetës në brigjet e detit të përbashkët, ruajtja e biodiversitetit dhe administrimi më i mirë i pellgjeve lumore nëpërmjet rregullimeve konkrete dhe zbatimi i regjimeve të bazuara në respektimin e shërbimeve të ekosistemit në tokë, në bregdet dhe në det në rajonin Adriatik dhe Jon. Më shumë informacion mund të gjeni në adresën: <https://www.adriatic-ionic.eu/about-eusair/pillars/green-pillar/>.

Hyn në fuqi rregullorja, jo më reklamim të ushqimeve të pashëndetshme në shkolla

plotësojë dhe rregullimet e legjislacionit për mbrojtjen

ose përfshihen në programet për të mitur, të ushqimeve e pijeve që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të fëmijëve, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acidi yndyror, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për fëmijët.

Lista e ushqimeve të ndaluara:

1. Ëmbëlsira: çokollatë dhe produkte çokollate (çokollatë e thjeshtë ose e bardhë, vezë të mbushura me çokollatë, çokokrem); – produkte të veshura me çokollatë (p.sh. biskota pjesërisht ose plotësisht të veshura, fruta ose arra të veshura me çokollatë,

akullore dhe drithëra të veshura me çokollatë); – ëmbëlsirë, përfshirë ëmbëlsirat “pa sheqer” (p.sh. çamçakëz, xhelatina, likuircia, kamele të çdo lloji përfshirë: menta, lëpirëse sheqeri, ëmbëlsira me sherbet, marshmallows, dhe ëmbëlsira të tjera); -çokollatë, kos ose fruta të thata dhe arra të veshura me sheqer; -bareta drithërash, ëmbëlsira me fruta të përpunuara.

2. Ushqime të skuqura ku përfshirë produktet e skuqura thellë në procesin e prodhimit. Kjo përfshin për shembull: patatina, salsicë të skuqura, kofshë pule të skuqura, petulla etj.

3. Ushqime të aromatizuara (savory snacks): Ushqime të aromatizuara me përmbajtje yndyre, yndyre të ngopur, na-

triumi dhe sheqeri mbi kriteret e mëposhtme: -madhësi paketi mi të barabartë ose më të madhe se 25 g; -22g ose më shumë yndyrë për 100g; -2g ose më shumë yndyrë të ngopur për 100g; -0.6g ose më shumë natrium për 100g; -3g sheqer ose më shumë në total për 100g;

4. Pijet freskuese (me ose pa gaz), duke përfshirë ujëra me aromë; -pijet e cilësuar si “pa sheqer” (me ose pa gaz) përf-

shirë ujërat me aromë; -pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar; -lëngjet e frutave të ëmbëltuara me sheqer të shtuar; -lëngjet e perimeve me sheqer ose kripë të shtuar; -lëngje të ëmbla të koncentruara, të bëra ose të aromatizuara me lëngje frutash, të cilat hollohen për të bërë një pije; -qumësht i plotë; -pijet energjike.

Lista e ushqimeve të lejuara:

• fruta të freskëta (frut i plotë ose në pjesë);

• fruta të konservuara në lëng natyral;

• perime të papërpunuara.



publikuar rregullorja bazohet në qasjen e sistemit të integruar të mbrojtjes së nxënësve nga mosha 6–15 vjeç, të cilët ndjekin arsimin bazë dhe në parimet e përgjithshme të sigurimit të të drejtave të fëmijës.

Kjo Rregullore synon të

e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, si edhe legjislacionin për mediat audiovizuale, në lidhje me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare që shoqërojnë

Sasia e rekomanduar	Mosha (vjeç)	
	5–10	11–15
Energjia në kcal (35% e energjisë ditore)	520–810	700–830
Proteina (g) 10–15% e energjisë së vaktit	13–30	18–31
Raporti proteinë shtazore kundrejt bimore	0.66	
Yndyrat (g) 30% e energjisë së vaktit	18–27	23–28
Yndyra të ngopura	6–9	8–9
Karbohidratet (g) (55–60% e energjisë së vaktit)	75–120	95–125
Sheqer i thjeshtë	13–30	18–31
Hekur (mg)	6	9
Kalcium (mg)	350	420
Fibra (g)	6	7.5



TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

INFORMACIONE

Java Botërore e ndërgjegjësimit antimikrobik

FAO rekomandon mbi përdorimin e antibiotikëve në mënyrë efektive në prodhimin e qumështit

Praktikat e drejta në blegtori mund të zvogëlojnë ndjeshëm nevojën për përdorim të antibiotikëve dhe rrjedhimisht kërcënimin ndaj rezistencës antimikrobike (AMR).

Për këtë qëllim, një botim i FAO-s ofron këshilla praktike për blegtorinë për përmirësimin e shëndetit të kafshëve dhe si rrjedhojë kufizimin e përdorimit të antibiotikëve. Botimi në përkrahje me fillimin e Javës Botërore të Ndërgjegjësimit Antimikrobik.

Publikimi është vazhdimi i një serie botimesh në ndihmë të blegtorëve (mbi shpendët, derra dhe lopë qumështi) si dhe jep rekomandime praktike për përdorim të kujdesshëm antimikrobik.

Mjekimet antimikrobike, veçanërisht me antibiotikë, u zhvilluan për të kuruar infeksionet bakteriale si te kafshët ashtu edhe te njerëzit. Megjithatë, përdorimi jo i duhur i tyre (përsa i përket marrjes së panevojshme të një ilaçi, një doze më tepër sesa

duhet, apo edhe i gabuar si mjet për parandalimin e sëmundjeve) mund të çojë në një situatë ku këto substanca ndalojnë së funksionuari. Kjo quhet rezistencë antimikrobike.

Nën moton “Trajtoni antimikrobikët me kujdes”, FAO, Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) u bëjnë thirrje të gjithëve që t’i bashkohen javës mbarëbotërore të ndërgjegjësimit dhe të bëhen kampionë të rezistencës antimikrobike.

Në nivel global, antibiotikët përdoren më shumë te bagëtisë sesa te njerëzit. Meqenëse bakteret rezistente mund të lëvizin nga bagëtia te njerëzit përmes kontaktit të drejtpërdrejtë ose ushqimit, interesi ynë i përbashkët është të kufizojmë përdorimin e antibiotikëve në bleg-

tori për të pakësuar shfaqjen e baktereve rezistente ndaj antibiotikëve edhe te njerëzit.

“Në këto botime, ne reko-



mandojmë tre masa kryesore për të parandaluar sëmundjet infektive në një fermë: mbajtjen e mirë, higjienën e kafshëve si baza për kafshë të

fuqishme dhe të shëndetshme; biosiguri efektive si një filter për të mbajtur sëmundjet jashtë portave të fermës; dhe vaksinat

për të mbrojtur kafshët kundër sëmundjeve specifike,” komentoi Eran Raizman, ekspert i lartë i shëndetit të kafshëve në FAO.

Në praktikë, në rastin e fermave të prodhimit të qumështit, kërkohet vëmendje për sasinë dhe cilësinë e ushqimit, shëndetin e lopëve, kujdesin e mirë të viçave, rutinën e mjeljes, përdorimin e fekondimit artificial, karantinimin për kafshët e reja, si dhe vaksinimin për sëmundjet që janë të pranishme në atë rajon.

Disa nga masat e parandalimit të sëmundjeve të publikuara në botim kërkojnë investime dhe kosto shtesë, ndërsa të tjerat bazohen në përmirësimin e aftësive të menaxhimit. Shumë prej tyre do të rrisin të ardhurat si në planin afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë.

“Fermierët që zgjedhin përdorimin e ulët të antibiotikëve tek kafshët mund të kenë akses në më shumë tregje me cilësi të lartë dhe me çmime më të mira”, shtoi Raizman.

Por pyetja mbetet: Si dhe kur të përdorim antibiotikët?

Trajtimi me antibiotikë mund të jetë i nevojshëm kur një kafshë ose një grup kafshësh sëmurët pavarësisht masave për parandalimin e sëmundjes dhe një specialist i trajnuar i shëndetit të kafshëve përshkruan ilaçe të tilla pas një diagnoze. Antibiotikët nuk mund të kurojnë infeksione virale që shpesh shkaktojnë sëmundje të frymëmarrjes dhe diarree. Gjithashtu, trajtimi duhet të synojë vetëm kafshën e sëmurë dhe duhet të shmangët praktika e përzierjes së ilaçit me ushqimin e kafshëve, ose ujin ku mund të shkojnë shumë kafshë.

Këshillat të publikuara në serinë e botimeve për përdorimin e antibiotikëve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme në fermat blegtorale, shpëndët dhe derri bazohen në qasje të provuara që janë testuar me sukses tek shëndeti i kafshëve dhe njerëzve pa penguar produktivitetin e lopëve.

Politikat e copëtuara për bujqësinë

me të, zhvillimi i industrisë përpunuese, mbeten të shumta. Ato fillojnë që nga copëzimi i tokës që nuk lejon ekonominë e shkallës dhe pengon kreditimin (që zë më pak se 1% të totalit) ndërprerjet në zinxhirin e prodhimit, informalitetin e lartë dhe deri te politikat (mos) mbështetëse e çorientuese që janë ndjekur vazhdimisht.

Pavarësisht rritjes së eksporteve vitet e fundit, të nxjerr kryesisht nga prodhimet e freskëta të frutave e perimeve, të gjithë faktorët e sipërpërmendur kanë sjellë konkurruesmëri të ulët të sektorit, duke nxitur dhe emigrimin e popullsisë së zonave rurale.

Sidomos politikat e propozuara së fundmi nga institucionet shtetërore për bujqësinë rrezikojnë të prodhojnë rezultatet e kundërt për të cilin pretendohet dhe të zhbejnë dhe atë pak formalizimin dhe rritje që

po konstatohet vitet e fundit. Vendosija e TVSH-së prej 10% për lëndët e para bujqësore dhe heqja e kompensimit të TVSH-së për industrinë përpunuese, pasi në 2019-n ishte ulur nga 20 në 6% janë dhe dy masat më të kundërshtuara nga fermerët dhe shoqatat e agroindustrisë.

Industria përpunuese kishte filluar të ndiente pasojat që në 2020-n, kur ulja e kompensimit të TVSH-së nga 20 në 6% çoi për herë të parë në rritje të importit të qumështit, sipas të dhënave zyrtare nga Doganat, pasi prodhimi vendas u bë më pak konkurrues. Në të kundërt, deri në 2019-n, sektori kishte filluar formalizimin, e konstatuar nga rritja e numrit të fermerëve të regjistruar.

Protestat, deri në konflikte e bllokim rrugësh nga fermerët ndaj këtyre masave, të paktën një gjë e treguan të qartë: që këto politika nuk ishin të kon-

sultuara aspak me grupet e interesit. Këta të fundit ankohen se nuk merren seriozisht dhe në disa raste, as nuk janë pritur nga institucionet vendimmarrëse.

Në relacionet e ndryshimeve ligjore, skemat e subvencionit që do të zëvendësojnë heqjen e kompensimit të TVSH-së, janë të përmendura shkarazi dhe të paqarta. Mungon dhe një analizë e qartë e segmenteve që do të preken nga ndryshimet dhe si skemat e reja do të arrijnë që të mbyllin të çarat, të ulin formalitetin, të nxisin mbylljen e ciklit dhe të rrisin efikasitetin e sektorit. Nga ana e tyre, aktorët e tregut ankohen se këto ndryshime do të “fundosin” fermerët, pasi pritet të rrisin koston e prodhimit dhe informalitetin (shiko shkrimin në faqen e brendshme të revistës).

P.sh., agroindustria vazhdon të jetë zinxhiri i këputur i

vlerës në sektorin e bujqësisë. Ky sektor, për shkak të kostove të larta që prodhon mungesa e ekonomisë së shkallës, vuan nga fitimet e ulëta. Prodhimet e fushës, sidomos ato që teprojnë dhe nuk kanë kualitet të lartë, duke u përpunuar do të shiteshin me çmime shumë të larta dhe në këtë mënyrë, do të rrisnin edhe fitimet për prodhuesit. Ekspertët pohojnë se duhen disa investime që nuk kushtojnë shumë, por mund të rrisin ndjeshëm fitimet në këtë sektor.

Konflikti qeveri-biznes (fermerë, agropërpunues etj.) nxjerr dhe një herë në pah mungesën e politikave afatgjata zhvillimore dhe pasojat që sjellin politikat e copëtuara për bujqësinë. Ndërsa disa probleme si copëzimi i tokës janë strukturore dhe është e vështirë të zgjidhen, me pak vullnet, identifikim të problematikave,

analizë të të gjithë zinxhirëve prodhues, tregtues e përpunues e mbi të gjitha, bashkëpunim mes palëve e mbështetje nga skemat e subvencioneve apo garancisë, mund të hartohet dhe realizohet një strategji ndërhjesh, që do të ndikonte në rritjen e vlerës së shtuar në shumë hallka.

Alternativat për zgjidhjet, propozimet dhe rezultatet e pritshme mund të jenë të shumta. E rëndësishme është që marrëdhëniet qeveri-biznes të kalojnë në një fazë tjetër bashkëpunuese, përpara se të merren vendimet dhe ndryshimet legjislativë, ashtu siç është premtuar, të merren njëherë e mirë me konsensus mes gjithë palëve. Për më tepër, që bujqësia është sektori që do të ndikohet më së shumti nga ndryshimet klimatike, prandaj kërkon edhe strategji mitigimi të pasojave / risqeve të shtuara, me të cilat do të përballet ai në një të ardhme jo shumë të largët.

Për herë të parë fond mbështetës për riparimin e anijeve të peshkimit

(Vijon nga faqja 6)

peshkatari do të vërë pjesën tjetër”.

Rama vuri në dukje se fondi i garancisë sovranë që ka vënë qeveria për bujqësinë dhe peshkimin duhet të vihet në lëvizje për kreditë që banka të garantojnë nga shteti.

“Për 4 vite rresht do financojmë çdo vit e më fuqishëm flotën. Kushdo që do të punojë dhe sakrifikojë në këtë biznes të vështirë ka gjithë respektin dhe mbështetjen tonë dhe do ta ketë”, shtoi Rama.

Kryeministri Rama theksoi: “Këtu duhet të bëhet marketa model e peshkut. U bë e Shëngjinit, u bë e Vlorës, tani duhet të bëhet këtu në Durrës. Zv.ministri i Bujqësisë bashkë me drejtorin e portit

të Durrësit do të uleni bashkë dhe gjithë kjo pjesë, duke përfutur edhe nga projekti i madh i transformimit të portit duhet të bëhet aksesibël për qytetarët”.

“Duhet të bëhet një bulevard me gjithë prodhimet e peshkut, me restorante, një markatë me standarde më të larta në Ballkanin Perëndimor. Gjëja më e mirë është që kjo markatë të jetë në bashkëpunim. Gjithë ju që jeni këtu, kush do që të futet aksioner me një përqindje të caktuar në këtë markatë të futet. Ministrja dhe ne bashkërisht do t’ju mbështesim. Ne si qeveri të garantojmë financimin, ju do fusni një pjesë të vogël. Menaxhimin do e bëni ju, jo shteti. Duhet të krijoni ju një autoritet më vete. Merrni ekspertë të huaj, shkoni gjeni

ku janë më të mirët, caktoni një drejtor të markatës që të jetë me eksperiencë ndërkombëtare. Vitin e ardhshëm duhet të hapim themelet e markatës”, tha Rama.

Kreu i qeverisë bëri të ditur gjithashtu se duhet një shkollë, nuk diskutohet, sepse sa më shumë ju po rriteni aq më shumë kemi problem në specialistëve të nivelit të lartë.

“Na duhet patjetër të ndërtojmë shkollën profesionale që të jetë në shërbim të industrisë dhe e lidhur drejtpërdrejt me praktikën. Duhet të fillojmë punën, duhet të përcaktojmë se ku është vendi i duhur për shkollën dhe të fillojmë menjëherë punën. S’kemi asnjë problem ta përfshijmë në planin e madh të portit të Durrësit”, tha Rama.

2022, viti ndërkombëtar i peshkimit dhe akuakulturës artizanale

Peshkimi dhe akuakultura në Shqipëri, do të jenë në fokus të veprimtarive dhe nismave mbështetëse të qeverisë vitin që vjen, në kuadër kjo edhe të lançimit nga FAO të 2022-shit si Viti Ndërkombëtar i Peshkimit Artizanal dhe Akuakulturës (IYAFA 2022).

Në takimin online që u organizua me këtë rast, përfaqësues të lartë të FAO-s, prezantuan qëllimet dhe objektivat e IYAFA 2022 dhe apeluan që qeveritë të adresojnë për peshkimin në vendin e tyre, sa më shumë veprimtari gjatë gjithë vitit të ardhshëm.

Qeveria shqiptare i ka kushtuar rëndësi të veçantë sektorit të peshkimit dhe akuakulturës gjatë viteve të fundit. Subvencionet dhe programet e IPARD kanë mbështetur industrinë e përpunimit të peshkut, duke

rritur vlerat e financimit për këtë sektor, deri në 30 milionë lekë për një biznes.

Ndërsa investimet e kombinuara më kërkesën në rritje të tregut të huaj, kanë sjellë që eksporti i peshkut të shënojë rritje të ndjeshme vitet e fundit.

Në kuadër të marrëveshjes tregtare me BE-në, industria shqiptare e përpunimit të peshkut mund të eksportojë drejt Europës rreth 1600 tonë peshk të përpunuar, açuge të konservuar.

IYAFA 2022, është një mundësi për të promovuar një botë në të cilën peshkatarët artizanë, fermerët e peshkut dhe përpunuesit e peshkut të njihen, të thellojnë ndërvëprimin dhe fuqizohen për të vazhduar kontributin e tyre në mirëqenien njerëzore. Sistemet e ushqimit të shëndetshëm kontribuojnë në

çrrënjësosjen e varfërisë përmes përdorimit të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm të burimeve të peshkimit dhe akuakulturës.

Drejtori i përgjithshëm i FAO-s, Qu Dongyu, përshëndeti në nisje të takimit virtual, ndërsa Editrudith Lukanga, zëvendëskryetare e Komitetit Drejtues Ndërkombëtar të IYAFA, foli për peshkatarët e vegjël.

Dëshmitë në lidhje me kapacitetin inovativ të peshkimit dhe akuakulturës në shkallë të vogël, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm u prezantuan nga aktorë të ndryshëm në takim.

Manuel Barange, drejtor i Divizionit të Peshkimit dhe Akuakulturës në FAO apeloj për një veprim global për të ndihmuar që IYAFA të bëhet një ndërmarrje e rëndësishme njëvjeçare.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga gazeta 424

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

Tabela 1. Nevojat ushqimore te lopeve Holshtein sipas stadit te laktacionit

Emertimi	Stadi i laktacionit		
	Fillim	Mes	Fund
Prodh. Mesat. Qumeshtit	40	30	20
Lëndë e thate (kg/ditë)	24-26	21-23	11-12
Proteinë bruto (% ndaj l. thatë)	17-19	15-16	13-15
PPP(% ndaj prot.bruto)	35-40	30-35	25
Prot. tretshme (% ndaj	25-33	25-36	25-40
NDF (% ndaj l. thatë)	30-34	30-38	33-42
ADF (% ndaj l. thatë)	19-21	19-23	22-26
Fiber efektive (% ndaj NDF)	25	25	25
E NL (Mkal/kg)	1.64	1.57	1.5
NFC (% ndaj l. Thatë)	30-42	30-44	30-45
TDN (% ndaj l. Thatë)	72-74	69-71	66-68
Yndyre(max. ndaj l. thatë)	5 -6	4*-/6	3-5
Kalcium-Ca (% ndaj l. thatë)	0.8-1.1	0.8-1.0	0.7-0.9
Fosfor- P (% ndaj l. thatë)	0.5-0.9	0.4-0.8	0.4-0.7
Kalium-K(% ndaj l. thatë)	0.9-1.4	0.9-1.3	0.9-1.3
Natrium-Na (% ndaj l. thatë)	0.2-0.45	0.2-0.45	0.18-0.45
Klor-Cl (% ndaj l. thatë)	0.25-0.30	0.25-0.30	0.25-0.30
Squfur-S (% ndaj l. thatë)	0.22-0.24	0.20-0.24	0.20-0.22
Kobalt-Co (mg/kg l. thatë)	0.2-0.30	0.2-0.30	0.2-0.30
Baker-Cu (mg/kg l. thatë)	15-30	15-30	12-30
Magnez-Mg (mg/kg l. thatë)	60	60	50
Zink-Zn (mg/kg l. thatë)	80	80	70
Jod -J (mg/kg l. thatë)	0.8-1.4	0.6-1.4	0.6-1.2
Hekur-Fe (mg/kg l. thatë)	100	75-100	50-100
Selen Se (mg/kg l. thatë)	0.3	0.3	0.3
Vitaminë A (1000UI/ditë)	100-200	100-200	100-200
„ D (1000UI/ditë)	20-30	20-30	20-30
„ E (UI/ditë)	600-800	400-600	400-600

Tabela 2. Ushqime të përdorur sipas prodhimit ditor dimër verë.

Lloji i ushqimit	Sasi e ushqimit që duhet përdorur sipas prodhimit ditor/kg									
	10 litra		15 litra		18 litra		21 litra		25 litra	
	V	D	V	D	V	D	V	D	V	D
Silazh misër kalli	10	20	12	18	12	20	12	20	12	20
Jonxhë e njomë	30	-	30	-	30	-	30	-	30	-
Tërfil		10	-	12	-	15	-	15		20
Panxhar		8		8		8		10	-	10
Bar jonxhe	1.5	2	2	3	2	3.5	2	3.5	2.5	3.5
Bar loliumi	2	2	2.5	2	2.5	1	2.5	1	2	1
Përzjerje kon	1	1	1.5	1.5	2.5	2	3.5	3	4.5	4
V.O. V= verë D=dimër										
Racioni ushqimor për lopë me peshë trupore 500kg /prodhimi ditor i qumështit nga 10 deri në 25 litra, Periudha Maj-Tetor, Yndyra 3.8 - 4%, Proteina 3.4%										

Tab. Nr. 3 Sasia e ushqimit ditor sipas prodhimit ditor/kg

Lloji i ushqimeve	Njesia matëse	Mëshqera barse		4-8 javë para pjelljes	0-4 javë para pjelljes
		V	D		
Silazh misër kalli	Kg	15	15	8	10
Jonxhë e njomë	Kg	10	X	8	5
Tërfil	Kg	X	6	X	X
Panxhar	Kg		5	X	X
Bar jonxhe	Kg	2	2	3	3
Bar loliumi	Kg	1	1	2	2
Përzjerje koncentrat	Kg	1.5	1.5	1.5	2.5
Racion ushqimor për lopë me peshë trupore 500kg					
Prodhim ditor 10-25 litra					
Periudha Maj - Tetor					
Yndyra 3.8-4%					
Proteina 3.4%					

Tab. Nr 4 Sasia e ushqimit ditor sipas prodhimit ditor/kg

Lloji i ushqimit		Sasia e ushqimit ditor sipas prodhimit ditor/kg				
		10 litra	15 litra	18 litra	21 litra	25 litra
Silazh misër kalli	Kg	10	12	12	12	12
Jonxhë e njomë	Kg	30	30	30	30	30
Tërfil	Kg					
Panxhar	Kg					
Bar jonxhe	Kg	1.5	2	2	2	2.5
Bar loliumi	Kg	2	2.5	2.5	2.5	2
Përzjerje	Kg	1	1.5	2.5	3.5	4.5
L.TH.	Kg	12.6	14.9	14.97	16.05	17.56
ENQ	Mj	62.84	75.56	88.26	95.23	101.16
Protein bruto	Kg	1.72	1.95	2.068	2.292	2.437
Raporti Ca/F	Gr	4.4/1	4.4/1	4,1/1	3.8/1	3.7/1
Fibër bruto	%/L/Th	29.82	29.03	28.13	26.93	26.2
Racion ushqimor për lopë me peshë trupore 500kg						
Prodhim ditor 10-25 litra						
Periudha Maj –Tetor						
Yndyra 3.8-4%						
Proteina 3.4%						

Tab.5 Sasia e ushqimit ditor sipas prodhimit ditor/litra

Nr.	Lloji i ushqimit	Njësia matëse	Sasa e ushqimit ditor sipas prodhimit ditor/litra				
			10	15	18	21	25
	Silazh misër kalli	Kg	20	18	20	20	20
	Jonxhë e njomë	Kg	X	X	X	X	X
	Tërfil	Kg	10	12	15	15	20
	Panxhar	Kg	8	8	8	19	10
	Bar jonxhe	Kg	2	3	3.5	3.5	3.5
	Bar loliumi	Kg	2	2	1	1	1
	Përzjerje koncentrat	Kg	1	1.5	2	3	4
	L.TH.	Kg	X	14.24	15.27	16.75	17.52
	ENQ	Mj	X	81.75	91.73	103	110.74
	Protein bruto	Kg	X	1.947	2..058	2.12	2.289
	Raporti Ca/F	Gr	X	3.7/1	3.1/!	2.8/1	2.6/!
	Fibër bruto	%/L/Th	X	24.45	23.94	22.01	21.37

(Vijon në faqen 12)

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

Tab. 6 Racioni ushqimor për lopë në tharje me peshë trupore 500 kg				
Nr.	Lloji i ushqimit	Njësia e matjes	4-8 javë para pjelljes	0-4 javë para pjelljes
1	Silazh misër kalli	Kg	8	10
2	Jonxhë e njomë	Kg	8	5
3	Tërfil	Kg		
4	Panxhar	Kg		
5	Bar jonxhe	Kg	3	3
6	Bar loliumi	Kg	2	2
7	Përzjerje koncentrat	Kg	1.5	2.5
8	L.TH.	Kg	10.34	10.39
9	ENQ	Mj	53.33	61.02
10	Protein bruto	Kg	1.16	1.21
11	Raporti Ca/F	Gr	3.3/l	2.8/l
12	Fibër bruto	%/L/Th	28.5	26.8

Tab.7 Sasia ditore e ushqimit që përdoret për vikat (periudha Maj-Tetor							
Nr.	Ushqimet	Njësia e matjes	0-4	0 - 4	6 – 12	12 – 20	Mëshqera barse
			Muaj	Muaj	Muaj	Muaj	
1	Silazh misër kalli	Kg	1	3	5	10	15
2	Jonxhë e njomë	Kg	X	1	10	10	10
3	Tërfil	Kg	X	X	X	X	X
4	Panxhar	Kg	X	X	X	X	X
5	Bar jonxhe	Kg	1	2	2	2	2
6	Bar loliumi	Kg	0.4	2	1	1	1
7	Përzjerje koncentrat	Kg	1	1.5	1.5	1.5	1.5
8	L.TH.	Kg	X	4.1	6.33	7.84	9.34
9	ENQ	Mj	X	25.6	38.3	47.5	56.6
10	Protein bruto	Kg	X	0.58	0.92	1.07	1.21
11	Raporti Ca/F	Gr	X	2.48/l	3.26/l	3.04/l	2.86/l
12	Fibër bruto	%/L/Th	X	17.8	16.7	16.4	16.26

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

(Vijon në numrin pasardhës)

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Meqenëse ka filluar sezoni i dimrit, dhe mund të ketë reshje të shumta; fermerët duhet të ndër-marrin masa për kullimin e ngastrave të mbjella me kulturat, grurë, elb dhe foragjere.

Kullimi i tokave ka si qëllim krijimin e një raporti të drejtë ujor- ajror midis bimës dhe tokës.

Ajo shërben gjithashtu dhe për punimet e ngastrave të tokës për mbjelljet e kulturave pranverore.

Të mbahen nën kontroll gjatë gjithë periudhës së dimrit të gjitha ngastrat e mbjella me kulturat e vjeshtës, pasi lagështia e tepërt, krijon humbje

KËSHILLA DHE INFORMACION PËR FERMERËT

të numrit të bimëve pengon në rritjen dhe zhvillimin normal të bimës, dhe si pasojë e kësaj ka ulje të theksuar të rendimentit, prekjen e bimeve nga semundjet, dhe farë të një cilesie jo brenda standarteve që kerkohet sot nga tregu, konsumatori dhe

agro-përpunuesit e drithrave.

Fermerët të cilët janë në proces të mbjelljeve të kulturave të lashta të përdorin farë të kontrolluar, të pastër nga ana fitosanitare, dezinfektuar dhe certifikuar, gjë e cila krijon garanci tek fermerët.

Drejtoria e Teknologjive Bujqësore: QTTB-Korçë:
E-mail:qttbkorce@yahoo.com

Për zonat paramalore, kodrinore fermerët të përdorin për mbjelljen e grurit normën 28-30 kg për dy ndërsa për zonat e thella malore noma e farës rritet me 10 %. Për kulturën e elbit distik dhe polistik vjesh-tor fermerët të mbjellin me normë fare 20-22 kg/dy, pasi siç përmendet edhe më lart ka shumë rendësi sigurimi i numrit të bimëve e cila për kulturën e grurit numri i bimëve duhet të jetë mesatarisht 40-45 mijë bimë/dy ndërsa për kulturen e elbit numri i bimëve mesatarisht duhet të shkojë 45-50 mijë bimë/dy pasi koeficienti i vllazërimit është më i madh.

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

(Vijon nga numri i kaluar)

Kontrolli biologjik

Kjo teknikë bazohet në përdorimin e armiqëve natyral kundra Ceratitis capitata. Ekzistojnë një numër jo i vogël parazitësh ndaj mizës mesdhetare të frutave. Dy parazitët: Diachasmimorpha tryoni dhe Fopius arisanus (Figura 7), gjatë përdorimit të tyre, kanë arritur rezultate shumë të mira edhe në Amerikë dhe Australi.

Megjithatë, duket se rezultatet nuk janë aq të mira në rajonet e përmendura më lart, pasi kushtet mjedisore janë të ndryshme. Për këtë arsye kërkohen parazitë autokton të cilët janë përshtatur mirë në rajonin ku gjenden, si Spalangia (Spalangia cameroni), të cilët kanë efektivitet më të lartë (Falco. 2006).

Efektiviteti i kontrollit do të ishte më i lartë nëse



Parazitët biologjike të mizës së frutave.

MIZA MESDHEHETARE E FRUTAVE (CERATITIS CAPITATA)

popullata e mizës mesdhetare është e ulët. Nëse niveli i infeksionit është i lartë, ky sistem nuk përdoret, por është plotësisht në përpunshmëri me alternativa të tjera më efikase, si gracka masive.

Një tjetër bio-kontrol potencial mund të gjejmë me përdorimin e kërpudhave entomopatogjene si Beauveria bassiana, të cilat veprojnë si micoinsekticide. Studime në laborator kanë dhënë rezultate inkurajuese (Porras dhe Lecuona, 2008).

Konkluzione

Në vitet e fundit, sektori i bujqësisë, ka pësuar një ndryshim në mentalitet që e detyron të përshtatet me rregulla të reja loje (rregullat e reja evropiane) dhe kërkesat e reja të konsumatorëve (prodhime me sa më pak pesticide).

Brënda kësaj situatë sociale duhet të jetë në qëndër idea e kontrollit të integruar, bazuar në përdorimin e përshtatur dhe të kombinuar, kur është e nevojshme, në dispozicion të metodave të ndryshme të kontrollit.

Drejtoria e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë
E-mail: qttbvlore@yahoo.com

sinjali për fillimin e trajtimeve kimike.

Për luftimin e mizës mesdhetare të frutave (C.Capitata) është e nevojshme që fermerët të grupohen në koperativa, pasi kështu arrihet të organizohet puna për trajtime në sipërfaqe më të mëdha, duke rritur ndjeshëm efikasitetin e spërkatjes ndaj këtij dëmtuesi i cili vitet e fundit po shkakton dëme të ndjeshme në prodhimin e agrumeve dhe më gjërë në vëndin tonë.

BIBLIOGRAFIA

Murraj XH. Manual i dëmtuesve kryesor të kulturave bujqësore.1968

Murraj Xh. Një dëmtues i rrezikshëm i pemëve frutore. Buletini i shkencave bujqësore, 1969

Alonso, A; García, F. 2007. “Comparación de cuatro tipos de mosqueros comerciales de captura de hembras y machos de Ceratitis capitata (Diptera:Tephritidae)”. Bol. San Veg Plagas. 33 (3): 399-408.

Lucas-Espada, A; Hermosillo-Cerón, A. 2008. “Evaluación de la eficiencia en la captura de mosca de la fruta (Ceratitis capitata) de varios mosqueros y cebos, en cultivos de cítricos”. Levante Agrícola. 390. 2º Trimestre 169-178.

Navarro-Llopis, V; Sanchis, J; Primo-Millo, J. And Primo-Yufera, E. 2007.

“Chemosterilants as control agents of Ceratitis capitata (Diptera: Tephritidae) in field trials”. Bull. Entomol. Res. 97: 359-368.

Pamja e qiellit gjatë muajit dhjetor 2021

Më 4 dhjetor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të

Kalendari bujqësor, muaji dhjetor 2021

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

të jetë5°C. Temperaturat e larta ditore do të ulen me 3°C, nga 14°C në 11° C, rallë do të bien nën 7° C ose do të tejkalojnë 18° C. Temperaturat e ulëta ditore do të ulenme rreth 3°C, nga

Parashikimi i motit për muajin dhjetor 2021 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	8	16	6/18/2016	0	0	6	6	LJL	LJL	2	Re që i hapin rrugën pak Dielli	
2	8	17	4/16/2016	14.9	10.5	11	13	LJL	JL	1	Kryesisht me re; shi me pika në mëngjes i ndjekur nga një shi i vogël pasdite	
3	10	17	9/15/2015	21.9	10	15	6	J	JJL	1	Re;periudhë me shi në mëngjes i ndjekur nga shi dhe stuhi pasdite	
4	9	17	8/18/2018	7.5	3.5	7	7	LVL	VVL	1	Re	
5	9	16	11/17/2016	0	0	7	6	VL	V	1	Re që i hapin rrugën pak Dielli	
